



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 408 Akti

Nr. 412 Vendimi
Tiranë, më 6.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 29.6.2021, në orën 13:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kreshnik Omari, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, i pranishëm në seancën dëgjimore.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Kreshnik Omari është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Kreshnik Omari, u shortua në datën 16.12.2019. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Valbona Sanxhaktari dhe komisionerët Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Vëzhgues ndërkombëtar i çështjes është caktuar z. Francesco Ciardi.

3. Në datën 8.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, i cili ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisionerin Olsi Komici.

4. Subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

6. Në datën 11.6.2021, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura për kriterin e pasurisë dhe, në vijim, vendosi mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Kreshnik Omari, vetëm për kriterin e pasurisë dhe, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

7. Komisioni njoftoi nëpërmjet postës elektronike subjektin e rivlerësimit, z. Kreshnik Omari, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe gjetjet e Komisionit, si dhe iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit të paraqitura nga Komisioni.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij për gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit. Së bashku me shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit përfshirjen në hetimin administrativ edhe të dy kriterëve të tjera të rivlerësimit, kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale.

9. Komisioni ka pranuar dhe administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura prej tij e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se nuk ka pranuar kërkesën e tij për riçeljen e hetimit administrativ dhe përfshirjen e dy komponentëve të tjerë të rivlerësimit, pasi deri në këtë fazë të hetimit konstatohen problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin i ka kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

10. Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit z. Kreshnik Omari në seancë dëgjimore në datën 29.6.2021, në orën 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve.

11. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent në seancën dëgjimore, e cila u zhvillua në ambientet e Pallatit të Koncerteve në datën 29.6.2021, në orën 13:00, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në këtë seancë, subjekti paraqiti shpjegimet lidhur me rezultatet e hetimit dhe qëndrimin lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar.

12. Në përfundim, subjekti i kërkoi Komisionit hapjen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, atë të figurës dhe aftësive profesionale dhe, në vijim, konfirmimin e tij në detyrë.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie*, në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

14. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)¹ ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit Kreshnik Omari ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017² të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi.

16. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë si vijojnë:

1. Apartament me sip. 74 m², me vlerë 9,098 (nëntë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë, në “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë. Origjina: përfitur gjatë procesit të privatizimit të banesave shtetërore. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pjesën takuese 50% përfitimim nga trashëgimia e babait F. O. të 50% të 1/3 pjesë të babait të tij te ky apartament banimi në vitin 2011.

1.1 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri ka konfirmuar³ për Komisionin këtë pasuri të regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij E. O. dhe nga dokumentacioni i dërguar po nga ky institucion, rezulton se:

- a) apartamenti me sip. 74 m² është blerë në shumën 9,098 (nëntë mijë e nëntëdhjetë e tetë) lekë, me kontratën e shitblerjes së datës 15.3.1994, nga Ndërmarrja Komonale Banesa nr. *** nga subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij;
- b) me vendimin nr. ***, datë 21.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar dëshmia e trashëgimisë së babait të subjektit të rivlerësimit, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë subjektin e rivlerësimit dhe nënën e tij, të cilët trashëgojnë nga ½ pjesë secili të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme;
- c) sipas kartelës së pasurisë datë 27.5.2020, apartamenti është i regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij.

1.2 Subjekti ka deklaruar këtë pasuri në DPV-në përkatëse dhe në deklaratën *Vetting*.

1.3 Lidhur me këtë pasuri nuk janë konstatuar problematika.

2. Shtesë anësore me sip. 48.6 m², 2 kate + bodrum, në pasurinë ekzistuese “apartament me sip. 74 m²”, deklaruar në vlerën 1,453,626 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë, ndërtuar nga babai i subjektit të rivlerësimit dhe i legalizuar nga ALUIZNI. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* shprehet se kjo shtesë është ndërtuar nga babai i tij para vitit 1997, i cili ka filluar edhe procedurën e legalizimit pranë ALUIZNI-t në vitin 2006. Kjo procedurë legalizimi është përfunduar pas

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë: 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratim të pasurive zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

²“41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

³Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2020, e ASHK-së Tiranë.

vdekjes së babait të subjektit të rivlerësimit dhe ka kaluar në favor të tij dhe të nënës së tij sipas dëshmisë së çeljes së trashëgimisë ligjore.

2.1 Në deklaratën e pasurisë për vitin 2003 (deklarimi për herë të parë, plotësuar datë 19.3.2004), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë apartament 2+1 dhe shtesë garazh plus dhomë, ndërtuar pas vitit 1990 (sip. totale 104 m²), sipërfaqja e shtesës është deklaruar si dhuratë nga babai.

2.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur⁴ nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, sqaron si vijon: *“Pavarësisht se pasuria figuronte e regjistruar që në vitin 1997 në bazë të kontratës së dhurimit, procedura e legalizimit u vu në lëvizje gjithsesi nga babai im, duke qenë se ndërtimi ishte përfunduar pa përfunduar procedura e dhënies së lejes së ndërtimit. Kjo, për të paguar detyrimet ndaj shtetit, si dhe për të pasur një regjistrim më ligjor të pasurisë, pra si rezultat i marrjes së lejes së legalizimit”*.

2.3 ZQRPP-ja ka konfirmuar⁵ për ILDKPKI-në se në emër të subjektit të rivlerësimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme është e regjistruar pasuria nr. ***, datë 19.9.1997, si vijon: *“Një shtesë prej 2 katesh me sip. trualli 20 m², e përbërë nga një dhomë në katin e parë dhe një dhomë në katin e dytë. Kjo shtëpi dykatëshe ndodhet prapa pallatit nr. ***, në ‘***’ Tiranë ... ”*, duke shoqëruar praktikën me dokumentacionin si vijon:

a) Kontrata e Dhurimit nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 9.1.1997, me dhurues shtetasin F. O. dhe pranues të dhurimit subjektin e rivlerësimit. Sipas kontratës, shtetasi F. O., në bazë të vendimit nr. ***, datë 14.5.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është pronar i një ndërtimi shtesë dykatësh, me sip. trualli 20 m², i përbërë nga një dhomë në katin e parë dhe një dhomë në katin e dytë, të cilën ia dhuron subjektit të rivlerësimit pa asnjë kusht apo shpërblim.

b) *Vendimi nr. ***, datë 14.5.1997, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga ku rezulton:*

i) babai i subjektit të rivlerësimit i është drejtuar gjykatës me kërkesën me objekt: “vërtetimi i faktit të ndërtimit të një shtëpie dykatëshe”;

*ii) shtetasi F. O., me shpenzimet e tij, në qershor të vitit 1996, ka ndërtuar një shtëpi dykatëshe, të përbërë nga një dhomë në katin e parë dhe një dhomë në katin e dytë, të provuara në seancë me Lejen e Ndërtimit nr. *** prot., datë 7.3.1996, me vendimin nr. ***, të KRRR-të Tiranë dhe dëshmitë e dëshmitarëve A. P. dhe Kreshnik Omari;*

iii) gjykata ka pranuar kërkesën duke vendosur vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit nga shtetasi F. O. të një shtesë dykatëshe, të përbërë nga dy dhoma, një në katin e parë dhe një në katin e dytë.

2.4 ASHK-ja konfirmon për Komisionin aplikimin nga shtetasi F. O. në procesin e legalizimit dhe pajisjen me leje legalizimi të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij, duke dërguar edhe praktikën përkatëse, nga e cila rezulton se shtetasi F. O. ka vetëdeklaruar për legalizim nëpërmjet shtojcës A1, datë 14.11.2006, objektin shtesë anësore, 1 kat, me sip. ndërtimi 17 m², në adresën: “***”, p. ***, Tiranë.

2.4.1 Sipas procesverbalit të konstatimit të datës 19.2.2013, mbajtur nga specialistët e Drejtorisë së ALUIZNI-t Tiranë, rezulton se sipërfaqja e sheshndërtimit është 16.2 m², sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit është 48.6 m², 2 kate mbi tokë dhe një kat nën tokë. Sipërfaqja shtesë prej 32.4 m² shfrytëzohet për banim, e ndarë në kate, përkatësisht nga 16.2 m² secili dhe sipërfaqja prej 16.2 m² për garazh. Sipas formularit të pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlera totale e investimit është llogaritur në vitin 2013 si vijon: 48.6 m² x 29,910 lekë = 1,453,626 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë.

2.4.2 Nga ALUIZNI Tiranë është lidhur Kontrata e Shitjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 15.4.2013 me subjektin e rivlerësimit dhe nënën e tij, për parcelën ndërtimore me sip. 16.2 m²,

⁴Shihni përgjigjen nr. 1, në pyetësorin datë 2.3.2020.

⁵Shihni shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2017, në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

me nr. pasurie ***, në z. k. ***, Tiranë, kundrejt vlerës prej 54,108 (pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e tetë) lekësh + taksë ndikimi në infrastrukturë 7,268 (shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë + tarifa e shërbimit 12,000 (dymbëdhjetë mijë) lekë + sanksioni për vonesë 1,620 (një mijë e gjashtëqind e njëzet) lekë, në zbatim të VKM-së nr. 900/2012, “Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”.

2.4.3 Nga ALUIZNI Tiranë është lëshuar Leja e Legalizimit nr. ***, datë 18.4.2013, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij, për objektin “shtesë anësore 2 kate + bodrum”, z. k. ***, nr. pasurie ***, me sipërfaqe totale ndërtimi për banim 32.4 m² dhe për aktivitet 16.2 m².

2.5 Drejtoria Vendore Tiranë e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës konfirmon për Komisionin se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij rezultojnë të regjistruara në bashkëpronësi nëpërmjet Lejes së Legalizimit nr. ***, datë 18.4.2013, pasuritë si vijon: (a) apartament me sip. 16.2 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***; (b) apartament me sip. 16.2 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***; (c) garazh me sip. 16.2 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

2.6 Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DIPV-në e vitit 2013 blerjen e parcelës ndërtimore me sip. 16.2 m² nga ALUIZNI dhe marrjen e lejes së legalizimit nga ALUIZNI dhe regjistrimin e saj pranë ZVRPP-së Tiranë.

2.7 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me mosdeklarimin e shtesës, shprehet se: *“Marrja e lejes së legalizimit në vitin 2013 nuk është deklaruar pasi kur e dërgova për regjistrim në ZVRPP Tiranë, me shkresën e tyre të datës 27.5.2013 (që po jua nis të skanuar) m'u përgjigjën se ‘Nuk mund t’ju pajisim me dokument pronësie deri në përfundim të regjistrimit të z. k. *** në sistem sistematik’”*. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe kopje të shkresës së datës 27.5.2013, të ZVRPP-së Tiranë.

2.8 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur⁶ nga Komisioni lidhur me shtesën informale, shprehet si vijon: *“Shtesa është ndërtuar në vitin 1995 nga babai im. Kur është ndërtuar shtesa unë kam qenë emigrant në Itali. Shtesa është ndërtuar në shtëpinë ku unë kam qenë bashkëpronar me prindërit si rezultat i privatizimit të banesave shtetërore. Nuk disponoj preventiva të shtesës, por në dijeninë time dhe me përafërsi, sepse kanë kaluar mbi 25 vjet, duhet të ketë kushtuar diku te 600,000 lekë”*.

2.9 Duke iu referuar deklarimeve të subjektit për ndërtimin e shtesës në vitin 1995, sipas EKB-së, kostoja e ndërtimit të saj ka qenë rreth 626,113 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e trembëdhjetë) lekë (48.6 m² x 12,883 lekë/m²).

2.10 Referuar sa më sipër, Komisioni vlerëson se pavarësisht pajisjes apo jo me dokument pronësie, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte deklaruar pranë ILDKPKI-së në DIPV-në e vitit 2013, blerjen e parcelës ndërtimore dhe marrjen e lejes së legalizimit për shtesën, duke deklaruar kështu sipërfaqen dhe të drejtat reale për këtë pasuri.

2.11 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, rezulton se:

a) Provohet se pasuria është krijuar rreth viteve 1990 – 1995 dhe se nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, i cili në atë periudhë nuk ka qenë në Shqipëri, si dhe as me ushtrimin e detyrës së tij si gjyqtar që fillon prej nëntorit të vitit 1997.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPV-në e vitit 2013 blerjen e parcelës ndërtimore me sip. 16.2 m² nga ALUIZNI dhe marrjen e lejes së legalizimit nga ALUIZNI lidhur me këtë pasuri. Duket se ajo nuk është e njëjtë me pasurinë e krijuar deri në vitin 1997, pasi këtu ka shtesë edhe një garazh (apo bodrum), si dhe subjekti i rivlerësimit dhe nëna e tij kanë përfutur edhe të drejtën e pronësisë mbi truallin shtetëror në të cilin është ngritur ky ndërtim informal.

⁶Shihni përgjigjen nr. 3, në pyetësorin datë 18.3.2021.

2.12 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me mosdeklarimet dhe mospërputhjet e konstatuara.

2.13 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar: “*Sqaroj se pagesat për parcelën ndërtimore, tarifën e shërbimit për legalizim, taksën e ndikimit në infrastrukturë për objektet informale dhe penaltetet për vonesë në vetëdeklarim për legalizimin e shtesës informale, janë kryer në funksion të legalizimit të ndërtimit informal. Që të mund të marrësh certifikatën e pronësisë nuk mjafton marrja e lejes së legalizimit, por ajo duhet të regjistrohet në ZRPP që të mund të quhesh pronar.*”

*Është kërkuar të kryhet regjistrimi në ZRPP në vitin 2013, por është kthyer përgjigje negative nga ZRPP-ja me shkresën datë 27.5.2013, ku thuhet: ‘Nuk mund t’ju pajisim me dokumentacion pronësie deri në përfundim të regjistrimit të z. k. *** në sistem sistematik’.*

Kjo pasuri është regjistruar në ZRPP në vitin 2019 dhe është deklaruar si pasuri nga ana ime në DIPV-në e vitit 2019, kopje të së cilës po jua vë në dispozicion.

Për sa i përket shtesës ajo është e njëjtë që kur është ndërtuar e derisa është legalizuar. Mospërputhjet vijnë si rezultat i diferencës ndërmjet asaj që është shkruar në vendimin e vërtetimit të faktit të gjykatës sipas deklarimeve të babait tim në atë kohë dhe verifikimit nga inspektorët kur u bë legalizimi”.

2.14 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit nuk është i saktë edhe në përputhje me ligjin dhe se nuk ka deklaruar procesin e legalizimit dhe të drejta reale mbi këtë pasuri të fituar nga ai proces. Shpjegimet e dhëna prej tij se pasuria nuk ishte regjistruar ende prandaj dhe nuk ishte deklaruar duken tërësisht të karakterit teknik dhe nuk ndikojnë në fitimin e të drejtave reale mbi këtë pasuri, si dhe deklarimin e shpenzimeve të kryera.

3. Pasuria garazh me sip. 11.5 m², në vlerën 2,725 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) euro, me adresë: rruga “****”, h. ***, Tiranë, z. k. ***, vol. ***, f. ***, nr. pasurie ***, blerë me Kontratën e Shitjes⁷ datë 1.10.2013. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të ardhurat.

3.1 Në DIVP-në e vitit 2013 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e kësaj pasurie, garazh me sip. 11.50 m², në vlerën 2,725 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) euro, por nuk ka përcaktuar burimin e të ardhurave të përdorura për blerjen e tij apo detaje e të dhëna të tjera.

3.2 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Veri ka konfirmuar⁸ për Komisionin këtë pasuri të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, duke dërguar edhe dokumentacion përkatës, nga i cili rezulton se:

a) Subjekti i rivlerësimit me Kontratën e Shitjes së datës 1.10.2013, ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë garazh me sip. 11.50 m², në vlerën 2,725 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) euro.

b) Në bazë të nenit 2 të Kontratës së Shitjes, çmimi i shitjes është shlyer plotësisht nga subjekti i rivlerësimit në zyrën noteriale në prani të noterit.

c) Sipas kartelës së pasurisë rezultoi se pasuria është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 29.10.2013.

ç) Në datën 30.10.2013 është kryer rivlerësimi i kësaj pasurie në shumën 1,096,410 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dhjetë) lekë. Ky çmim është sipas çmimit të referencës në vitin 2013 në këtë zonë (rruga “****”).

3.3 Nga analiza financiare për vitin 2013, Komisioni ka llogaritur vlerën e pasurisë/garazh në çmimin e deklaruar prej 2,725 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) euro (ekuivalent në lekë

⁷Kontrata e shitjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 1.10.2013.

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 4.6.2020, e ASHK-së Tiranë.

në vlerën 382,072 lekë) dhe në çmimin prej 1,096,410 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dhjetë) lekësh sipas çmimit të referencës nga ku ka rezultuar sa vijon:

Analiza janar-tetor 2013	Vlera e garazhit sipas kont. shitjes	Vlera e garazhit sipas cm ref.
<i>Pasuria</i>	<i>1.019.212</i>	<i>1.733.550</i>
Blerë garazh me sip. 11.5 m², tetor 2013	382.072	1.096.410
<i>Shtesa likuiditeti</i>	<i>637.140</i>	<i>637.140</i>
<i>Të ardhura të dokumentuara</i>	<i>1.208.403</i>	<i>1.208.403</i>
Të ardhura nga paga	852.391	852.391
Të ardhura të tjera (dëshmipërblim si ish i përndjekur politik)	307.500	307.500
Të ardhura nga interesat bankare	48.512	48.512
<i>Shpenzime në total</i>	<i>1.243.863</i>	<i>1.243.863</i>
Shpenzime jetese	352.560	352.560
Shpenzime sipas sistemit TIMS	371.463	371.463
Shpenzime për vajzën	300.000	300.000
Shpenzime për legalizimin	83.696	83.696
Shpenzime me kartë krediti	136.144	136.144
<i>Rezultati neto</i>	<i>-1.054.673</i>	<i>-1.769.011</i>

3.4 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, rezulton se:

a) Çmimi i kësaj pasurie i përcaktuar në kontratën e shitjes prej 2,725 (dy mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) euro duket se është fiktiv dhe mbi dy herë më i ulët se çmimi i referencës [një ditë pas regjistrimit kjo pasuri është rivlerësuar në shumën 1,096,410 (një milion e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dhjetë) lekë, duke e shtuar vlerën e saj më shumë se 2 herë].

b) Për Komisionin nuk duken bindëse shpjegimet e subjektit se e ka blerë këtë pasuri për ta përdorur për parkim, pasi shtëpia e tij ndodhet larg nga pasuria garazh.

c) Subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare me burime të ligjshme për të blerë këtë pasuri.

3.5 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

3.6 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar sa vijon:

*“Lidhur me çmimin e garazhit (faktikisht është vendparkim) prej 2,725 euro sqaroj se është prenotuar prej meje në vitin 2005 dhe çmimet e referencës duhet të merren në bazë të atij viti. Gjithashtu, në çmim duhet të kihet parasysh që nuk është garazh i mbyllur nga të katër anët, por vendparkim i hapur, në katin -1 të pallatit. Lidhur me prenotimin nga ana ime në vitin 2005 po ju paraqes kontratën e sipërmarrjes të firmosur në datën 15.4.2005 (3 fletë), vërtetimin e datës 18.6.2021, të lëshuar nga shoqëria ‘***’ sh.p.k. (1 fletë), si dhe kopje të 5 kontratave të shitjes (gjithsej 50 fletë) të disa garazheve në të njëjtin objekt me vit shitjeje 2013, 2014 dhe 2015 që përmbajnë çmim të përafërt ndoshta dhe më të ulët”.*

3.7 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të cituara më lart rezulton se subjekti ka paraqitur një kontratë jonoteriale, e cila ka një çmim të përafërt me kontrata të tjera të ngjashme të paraqitura prej tij si provë për disa banorë të tjerë, të cilët kanë blerë këto pasuri, por në ndryshim nga ata, subjekti i rivlerësimit ka paguar çmimin në vitin 2013 dhe jo në vitin 2005.

Kjo kontratë porosie nuk është deklaruar prej tij në DPV-në e vitit 2005 dhe është vendosur në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas çeljes së rezultateve të hetimit.

3.8 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave më sipër, si dhe shpjegimeve e provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit, trupi gjykues ka rishikuar analizën financiare duke pranuar disa kërkesa të subjektit lidhur me shpenzimet dhe duke i pranuar ato. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie në vlerën -1,441,290 (një milion e katërqind e dyzet e një mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë. Trupi gjykues ka vlerësuar të mbajë në konsideratë çmimin e kësaj pasurie, referuar çmimit të referencës dhe duke e konsideruar deklarin e subjektit të rremë. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij dhe se provat e paraqitura prej tij gjatë hetimit nuk gjenin mbështetje në deklarinet periodike vjetore dhe sfidonin logjikën.

4. Automjet tip “**”,** prodhim i vitit 1985, me targa *** (***) , në vlerën 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, blerë në datën 7.8.1999. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim krijim të ardhurat.

4.1 Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip “****”, me targa ***, në vlerën 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë, blerë nga kursimet familjare. Pjesë takuese: 100%.

4.2 Lidhur me këtë pasuri, DPSHTRR-ja konfirmon⁹ për Komisionin regjistrimin në pronësi të subjektit të rivlerësimit të këtij automjeti, duke vënë në dispozicion edhe dosjen e tij.

4.3 Sipas dokumentacionit rezulton se:

a) Sipas dokumentit “vërtetim hyrje” nr. ***, të Doganës Durrës, ky automjet ka hyrë në territorin e Shqipërisë nga kjo pikë doganore në datën 7.8.1999, nga shtetasi A. K.. Certifikata e pronësisë tregon se automjeti është në pronësi të shtetasit A. K. dhe vendi i origjinës është Italia.

b) Subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin në vlerën 1,500 (një mijë e pesëqind) DM (rreth 109,125 lekë¹⁰) me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 7.8.1999, nga shtetasi A. K., likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

c) Referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 9.8.1999, të Doganës Tiranë, zhdoganimi i automjetit është kryer nga subjekti i rivlerësimit, duke paguar shumën 165,305 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e pesë) lekë.

4.4 Subjekti i rivlerësimit ka paguar rreth 274,430 (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë) lekë për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti.

4.5 Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë pasuri. Lidhur me mundësitë financiare, nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën e deklaruar prej tij.

5. Automjet tip “**”,** prodhim i vitit 1995, me targa ***, në vlerën 220,000 (dyqind e njëzet mijë) lekë, blerë më 6.12.2004. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, deklaroi si burim krijimi të ardhurat.

5.1 Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DIPV-në e vitit 2004, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, por e ka deklaruar në DIPV-në e vitit 2005, duke deklaruar blerjen në shumën 220,000 (dyqind e njëzet mijë) lekë, të automjetit tip “****”, me targa ***. Pjesa takuese: 100%.

5.2 Lidhur me këtë pasuri, DPSHTRR-ja konfirmon¹¹ për Komisionin regjistrimin në pronësi të subjektit të rivlerësimit të këtij automjeti, duke vënë në dispozicion edhe dosjen e tij.

⁹Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2020.

¹⁰Sipas Bankës së Shqipërisë, kursi i këmbimit të markës gjermane në lekë në datën 6.8.1999 ka qenë 1 DM = 72.75 lekë.

¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2020.

5.3 Sipas dokumentacionit rezulton se:

a) Certifikata e pronësisë tregon se automjeti ka qenë në pronësi të shtetasit B. M. dhe është futur në territorin e Republikës së Shqipërisë nga Italia, në pikën doganore Durrës.

b) Subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin nga shtetasi B. M., në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë, me Kontratën nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 6.12.2004, e cila është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

c) Sipas dokumentit “vërtetim zhdoganimi”, datë 15.12.2004, të Doganës Tiranë, ky automjet ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë në datën 5.12.2004 dhe është zhdoganuar nga subjekti i rivlerësimit. Referuar deklaratës doganore të datës 15.12.2004, subjekti i rivlerësimit ka paguar detyrime doganore për këtë automjet në shumën 154,153 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

5.4 Referuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paguar shumën 354,153 (treqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti.

5.5 Në analizën financiare të Komisionit, për këtë pasuri është marrë në konsideratë vlera prej 354,153 (treqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh e subjektit, i cili ka pasur mundësi financiare për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2004.

6. Automjet tip “**”, prodhim i vitit 2008, me targa ***, në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë, blerë më 17.1.2013. Burimi i krijimit: të ardhurat.**

6.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip “****”, në DIPV-në e vitit 2013, blerë në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë, pa deklaruar burimin e të ardhurave të përdorura për blerjen e tij.

6.2 Për këtë pasuri, DPSHTRR-ja konfirmon¹² për Komisionin regjistrimin në pronësi të subjektit të rivlerësimit të automjetit, duke vënë në dispozicion edhe dosjen e tij. Sipas dokumentacionit rezulton se:

a) Automjeti tip “****”, më targa ***, është blerë në Itali nga shtetasja V. P., në datën 28.11.2012, në vlerën 9,000 (nëntë mijë) euro (rreth 1,257,390 lekë¹³).

b) Në bazë të deklaratës doganore të datës 2.12.2012, automjeti ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga pika doganore e portit të Durrësit, është zhdoganuar nga shtetasja V. P. dhe janë paguar detyrime doganore në shumën 255,991 (dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një) lekë.

c) Subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin nga shtetasja V. P. në vlerën 300,000 (treqind mijë) lekë, me Kontratën nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 17.1.2013, e cila është likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

6.3 Referuar sa më sipër, rezulton se shitësja (V. P.) ka paguar shumën prej 1,513,381 (një milion e pesëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekësh për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti në dhjetor të vitit 2012 dhe ia ka shitur subjektit të rivlerësimit një muaj më vonë (janar 2013) në shumën 300,000 (treqind mijë) lekë (rreth 5 pesë herë më lirë).

6.4 Nga kontrolli i hyrje-daljeve, në sistemin *TIMS*, të subjektit të rivlerësimit rezultoi se në datën 28.11.2012, ora 05:35, së bashku me shtetasen V. P. kanë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar Rinas në drejtim të Romës, Itali, me shoqërinë ajrore “****”.

6.5 Subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja V. P., në datën 2.12.2012, përkatësisht në orën 07:32 dhe 07:33, kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë nga pika e kalimit kufitar të Portit

¹²Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2020.

¹³Sipas Bankës së Shqipërisë, kursi mesatar i këmbimit të monedhës euro në lekë në muajin nëntor 2012 ka qenë 1 euro = 139.71 lekë.

Durrës me tragetin e shoqërisë “***”. Në sistemin *TIMS* rezulton se subjekti i rivlerësimit ka hyrë nga kjo pikë kufitare me automjetin e blerë nga shtetasja V. P. në Itali, me targa ***.

6.6 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja V. P. janë të njohur dhe kanë udhëtuar shpesh së bashku.

6.7 Nga verifikimi në Qendrën e Sigurimit të Detyrueshëm Motorik të AMF-së rezulton se për automjetin tip “Lancia Thesis”, prodhim i vitit 2008, me nr. shasie ***, është prerë polica e sigurimit të detyrueshëm motorik nr. serie ***, datë 2.1.2013, ku rezulton se pronare e automjetit është shtetasja V. P. dhe përdorues subjekti i rivlerësimit.

6.8 Analiza financiare e Komisionit ka marrë në konsideratë këtë shpenzim të kryer në vitin 2012, në vlerën 1,513,381 (një milion e pesëqind e trembëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni nuk ka përfshirë në analizë shpenzimet për transportin e automjetit/biletën e tragetit dhe nxjerrjen e dokumentacionit përkatës. Nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar në pamundësi financiare prej -1.513.381 lekësh për blerjen e automjetit në këtë vlerë.

6.9 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *Vetting* dhe në DPV lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, ka fshehur vlerën reale të saj, si dhe të shpenzimeve të tjera të kryera prej tij.

6.10 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kalon barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

6.11 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Siç e kam sqaruar më parë, me V. P. kam pasur miqësi. Më kishte thënë disa herë që pse nuk blen një makinë më të re se kjo që ke, tashmë i ka bërë 27 vjet dhe një ditë më tregoi një makinë në internet dhe më tha nëse më pëlqente një e tillë që ta blija për shumën 300,000 lekë. Mbasi më pëlqeu, më tha shkojmë në Romë për turizëm dhe marrim edhe makinën. Veprimet në Itali i bëri ajo meqë ishte më e thjeshtë pasi kishte edhe shtetësinë italiane dhe kur erdhëm në Shqipëri bëmë kontratën e shitjes për shumën 300,000 lekë. Pse ia vuri çmimin 300,000 lekë, ndërkohë që e paska blerë më shtrenjtë? Nuk di ta them. Ndoshta për shkak të marrëdhënies që kishim bashkë. Sidoqoftë nuk ka deklaram të rremë përderisa unë kam deklaruar si blerjen e makinës ashtu edhe çmimin aq sa e kam blerë faktikisht”.*

6.12 Në vlerësim të provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se nuk janë bindëse dhe se subjekti nuk ka arritur të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit. Diferenca dukshëm e lartë kundrejt çmimit të shitjes dhe atij të blerjes, faktet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit se shpenzimet e udhëtimit turistik kanë qenë të ndara, si dhe marrëdhënia e rezultuar nga hetimi mes shtetasës V. P. dhe nënës së subjektit të rivlerësimit dhe transfertat monetare të kryera mes tyre, nuk krijuan bindjen se deklarimet e subjektit ishin të vërteta. Trupi gjykues krijoi bindjen se automjeti i përkiste subjektit të rivlerësimit që prej momentit kur u ble dhe u soll në Shqipëri dhe se veprimet e kryera prej shtetasës V. P. ishin të qëllimshme, si dhe për të fshehur vlerën reale të këtij automjeti dhe shpenzime të tjera të kryera për të.

6.13 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë lidhur me pasurinë automjet tip “Lancia Thesis” dhe se ndodhet në kushtet e germave “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

7. Velierë me gjatësi 9 m, në vlerën 4,000 (katër mijë) euro, blerë në vitin 2015. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratën *Vetting* si burim të krijimit të ardhurat.

7.1 Në DIPV-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e velierës në tetor të vitit 2015. Burimi i krijimit: të ardhurat nga kursimet vjetore.

7.2 Drejtoria e Përgjithshme Detare ka konfirmuar¹⁴ për ILDKPKI-në që në emër të subjektit të rivlerësimit rezultoi e regjistruar mjeti velierë, me gjatësi 9 m, viti i prodhimit 2008, data e blerjes 13.10.2015, data e regjistrimit 23.12.2015, çmimi i blerjes 4,000 (katër mijë) euro, si dhe ka dërguar dokumentacionin përkatës. Nga dokumentacioni i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, rezultoi se:

a) Në bazë të deklaratës verbale për shitje varke, veliera është blerë nga subjekti i rivlerësimit në Itali në datën 13.10.2015, për çmimin 4,000 (katër mijë) euro.

b) Mjeti velierë është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit Durrës me nr. regjistri ***, datë 23.12.2015, me pronar subjektin e rivlerësimit.

7.3 Referuar dokumentacionit të depozituar¹⁵ pranë ILDKPKI-së, bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka paguar nëpërmjet bankës në datën 26.10.2015, shumën prej 231,000 (dyqind e tridhjetë e një mijë) lekësh për zhdoganimin e mjetit lundrues. Vlera e zhdoganimit të mjetit është thajse sa gjysma e vlerës së blerjes së tij. Duket se çmimi i blerjes është dukshëm më i ulët se ai referues.

7.4 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur¹⁶ nga Komisioni lidhur me shpenzime të mundshme për mjetin velierë, si dhe vendparkimin e tij, deklaroi se që në momentin e blerjes ia ka lënë në përdorim kushërit të tij L. B. në Vlorë dhe nuk ka shpenzime për të deklaruar.

7.5 Nga analiza e lëvizjeve të llogarisë në kartën e kreditit që subjekti i rivlerësimit ka në "Raiffeisen Bank" rezultoi se gjatë periudhës qershor-korrik 2016 ka kryer blerje *online* në vlerën 1,436 euro, në faqen ***¹⁷. Nga kërkimi në internet rezultoi se kjo faqe tregton produkte/aksesorë të ndryshëm për varka.

7.6 Nga analiza financiare e Komisionit është llogaritur vetëm vlera totale prej 781,600 (shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) lekësh (çmimi i varkës plus dogana), pa përfshirë shpenzimet për transportin nga Italia apo dokumentacionin përkatës, si dhe vendparkimin e mjetit dhe konsumim karburanti. Nga analiza financiare, subjekti ka rezultuar me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar blerjen e kësaj varke, për sa kohë që nga analiza financiare deri në tetor të vitit 2015 rezultoi me vlerë negative prej 976,796 (nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.

7.7 Gjatë hetimit, Komisioni është vënë në dijeni të një kontrate të lidhur në datën 12.4.2016 mes shoqërisë "****" sh.p.k. dhe shtetases E. O. (nëna e subjektit të rivlerësimit) me vitlindje 1934, me objekt marrjen me qira për 79 vjet (deri në datën 22.3.2095) në Marinën e Orikumit të një apartamenti me sip. 52.7 m² dhe të një vend për akostimin e një barke me gjatësi 12 m dhe gjerësi 3.80 m, nr. **, për vlerën prej 99,600 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) euro, e cilat është likuiduar tërësisht dhe është dorëzuar edhe sendi (apartament + vend barke). Ka rezultuar se pagesa e parë (paradhënie) është kryer në tetor të vitit 2015 nëpërmjet një transferte bankare të kryer nga znj. E. O. në shumën 16,600 (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro, pjesa tjetër duhet të jetë kryer *cash*. Klienti paguan plus edhe shpenzime të tjera për tatime, taksa, kosto regjistrimi, etj. Kjo pasuri është trajtuar më poshtë në këtë relacion në rubrikën "gjetje të tjera".

7.8 Në përfundim, lidhur me pasurinë velierë me gjatësi 9 m, në vlerën e deklaruar 4,000 (katër mijë) euro, blerë më 13.10.2015 duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i sigurtë dhe bashkëpunues me Komisionin lidhur me deklaratimet e bëra prej tij. Duket se pikërisht në këtë periudhë ka porositur (parapaguar) edhe vendparkimin.

Duket se subjekti ka pasur për qëllim fshehjen e vlerës reale të investimit dhe përdorimit të kësaj pasurie.

¹⁴Shihni dojen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

¹⁵Shihni dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

¹⁶Shih përgjigjen nr. 6, në pyetësorin datë 18.3.2021.

¹⁷*** - ricambi e accessori nautici.

7.9 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit për të shpjeguar dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

7.10 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se:

“Me ish-pronarin e velierës që kam blerë, kam miqësi të vjetër që nga viti 1997, kur punova në Napoli. Çmimi i referencës për të cilën u pagua dogana nuk është shumë më e lartë se 4,000 euro që pagova. Ai donte të ndërtonte një velierë tjetër më të madhe dhe nuk kishte leverdi që të mbante dy varka. Ky ishte edhe shkaku që e shiti. Edhe velierën që i bleva unë e kishte ndërtuar vetë dhe më tha nëse doja ta blija për 4,000 euro. Ky ishte çmimi që më dha dhe unë aq pagova. Nuk e kisha idenë se sa mund të ishte vlera e velierës në treg, aq më tepër që ishte prodhim amator dhe jo prodhim kantieri. Kam përshtypjen se çmimi i referencës nuk e mban parasysh faktin që veliera në fjalë ishte prodhim amator, i bërë nga vetë pronari, por i referohet velierave të prodhuara nga kantierët. Është logjike që prodhimet e kantierëve kanë çmime më të larta se prodhimet amatore. Nuk përjashtohet mundësia që për shkak të miqësisë të më ketë dhënë një çmim pak më të ulët (por jo shumë gjithsesi) se sa do ia kishte dhënë dikujt tjetër, por edhe sikur të jetë kështu, kjo më duket diçka normale mes shokësh. Në çdo rast, siç e thashë më sipër ky është çmimi real i paguar prej meje dhe nuk mund të deklaroja çmim tjetër”.

7.11 Trupi gjykues vlerësoi faktet dhe rrethanat e rezultuara gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimet e subjektivit të rivlerësimit në seancën dëgjimore (si dhe në prapësimet e tij në vijim të rezultateve të hetimit) dhe vlerëson se subjekti nuk ka provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Ai nuk është treguar i sinqertë dhe bashkëpunues me Komisionin duke bërë deklaramë të pasakta lidhur me vendparkimin e velierës me gjatësi 9 m, si dhe shpenzime të tjera të kryera lidhur me të cilat kanë rezultuar gjatë hetimit.

8. Depozitë bankare në shumën 135,019 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëmbëdhjetë) euro, në “Raiffeisen Bank”, çelur më 24.4.2015. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i krijimit: subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim krijimi të depozitës: (a) të ardhurat nga puna për 5 vjet si emigrant në Itali në periudhën 1991 – 1995; (b) të ardhurat si avokat për periudhën 1995 – 1997; (c) të ardhurat nga puna si gjyqtar nga viti 1997 deri aktualisht; (ç) të ardhurat e ish-bashkëshortes si avokate në periudhën 2003 – 2011 dhe si notere në periudhën 2011 – 2012 (divorcuar në korrik të vitit 2012); (d) trashëgimia e babait.

8.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, sqaron se të ardhurat në shumën 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro janë deklaruar *cash* në deklarin fillstar të vitit 2003 dhe diferenca prej 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro është krijuar në vitet në vazhdim.

8.2 Subjekti i rivlerësimit, në DIPV-në e vitit 2015, nuk e ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* dhe hapjen e kësaj llogarie bankare për depozitim të këtyre shumave.

8.3 Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* shumën 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro, me burim: (a) të ardhurat nga puna si emigrant për 5 vjet në Itali (1991 – 1996) për të cilën dispononte dokumentet përkatëse; (b) të ardhurat nga puna si avokat; (c) të ardhurat nga puna si gjyqtar.

Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e gjendjes *cash* 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro

8.4 Referuar sa më sipër, rezulton se gjendja *cash* prej 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro është krijuar deri në datën 31.12.2003.

8.5 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur¹⁸ nga Komisioni lidhur me shumën prej 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro, shpjegon se: “... për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk jam në gjendje të jap të dhëna të sakta për sa i përket ndarjes së sa kanë qenë nga puna në emigracion, sa nga puna si avokat dhe sa nga puna si gjyqtar. Gjithsesi, përafërsisht, mendoj se rreth 80-90% duhet të kenë qenë si rezultat i punës në emigracion dhe pjesa tjetër nga puna si avokat dhe gjyqtar”.

8.6 Referuar deklaratës *Vetting* dhe deklaratës fillestare të pasurisë së vitit 2003, burimet e të ardhurave të shumës 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, janë si vijon:

i. Të ardhurat nga puna për 5 vjet si emigrant në Itali në periudhën 1991 – 1995

8.7 Sikurse është shpjeguar nga subjekti i rivlerësimit, të ardhurat nga puna në Itali zënë rreth 80 - 90% të të ardhurave për krijimin e gjendjes *cash* prej 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro.

8.8 Lidhur me burimin e të ardhurave si emigrant në Itali, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting* fotokopje të Librezës së Punës nr. *** regj. të pa përkthyer dhe të pa noterizuar¹⁹, nga e cila vërtetohet vetëm punësimi në Itali dhe nuk përcaktohen të dhëna mbi të ardhurat e përfituara.

8.9 Komisioni kërkoi²⁰ nga subjekti i rivlerësimit që të shpjegojë me dokumentacion ligjor provues lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer si burim për gjendjen *cash* prej 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro, deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2003. Subjekti i rivlerësimit sqaron se gjatë periudhës që ka qenë në emigracion ka punuar shofer kamioni në rrugë të gjata dhe paga e tij ka qenë shumë e mirë. Në vijim, ka dhënë sqarime lidhur me punëmarrësit, periudhën e punës dhe pagesat përkatëse pranë secilit prej tyre. Sipas përlllogaritjeve të subjektit të rivlerësimit, gjatë punës në emigracion në Itali ka marrë në total shumën 167,762,348 lireta.

8.10 Lidhur me dokumentacionin ligjor provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave, subjekti i rivlerësimit ka depozituar fotokopje të dokumenteve të punëdhënësve të tij në Itali, në gjuhën italiane, të pa përkthyer dhe të pa noterizuara, si dhe kopje të disa disqeve që regjistrojnë orët e punës dhe shpejtësinë e lëvizjes së kamionit.

8.11 Referuar sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit nuk provon mundësinë e tij financiare sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me të ardhurat e krijuara nga puna në emigracion në Itali për 5 vjet, të cilat kanë shërbyer si burim për gjendjen *cash* prej 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro. Subjekti i rivlerësimit nuk provon sjelljen e shumave të pretenduara në Shqipëri, pasi deklaroi se janë mbajtur *cash* në një mënyrë tërësisht informale, e cila nuk mundëson provueshmërinë lidhur me ekzistencën e tyre (megjithëse nga hetimi rezultoi se subjekti ka pasur depozitë bankare/kursimesh në Fefad dhe ish-Banka e Kursimeve). Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këto të ardhura pranë organeve tatimore përkatëse kur ka ardhur në Shqipëri, sipas legjislacionit të kohës.

ii. Të ardhurat si avokat për periudhën 1995 – 1997

8.12 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shumën konkrete të të ardhurave të realizuara nga aktiviteti si avokat, e cila ka shërbyer për krijimin e gjendjes *cash* prej 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro, as në deklaratën fillestare të pasurisë (viti 2003) dhe as në deklaratën *Vetting*.

8.13 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me këtë shumë, nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka depozituar dokumentacion provues ligjor.

8.14 Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar:

¹⁸Shihni përgjigjen nr. 2, në pyetësorin datë 2.3.2020.

¹⁹Dosja e ILDKPKI-së (Aneks ***).

²⁰Shihni përgjigjen nr. 2, në pyetësorin datë 2.3.2020.

a) Lejen nr. ***, datë 27.8.1992, për ushtrimin e profesionit të avokatit, lëshuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Avokatisë.

b) QKB-ja informon²¹ Komisionin se nga verifikimi i kryer në bazë të emrit, rezulton se shtetasi Kreshnik Omari (atësia/datëlindja/nr. personal nuk mund të verifikohen) figuron i regjistruar si Person Fizik me vendimin nr. ***, datë 25.8.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NIPT dhe, si pasojë, nuk mund të garantojë nëse kemi të bëjmë me të njëjtin shtetas. QKB-ja ka dërguar gjithashtu edhe një kopje të vendimit nr. ***, datë 25.8.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

c) Certifikatë regjistrimi si biznes i vogël në organin tatimor nr. serial ***, për periudhën e veprimtarisë 1.1.1997 – 31.12.1997, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ushtron aktivitetin si avokat, me datë krijimi 10.10.1996.

8.15 Për llogaritjen e tatimit mbi biznesin e vogël për personat fizikë/avokatë, referuar ligjit nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, përcaktohet se personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë. Në zbatim të këtij ligji tatimi është llogaritur me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që janë realizuar nga shitja e mallrave apo shërbimeve, si dhe me kuota fikse sipas llojit të veprimtarive që ka ushtruar Personi Fizik. Ligji nr. 7679, datë 3.3.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël” është shfuqizuar me ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, duke ndryshuar më tej skemën.

8.16 Referuar sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar të ardhurat e tij nga aktiviteti si avokat dhe as xhiron e deklaruar për periudhën 1995 – 1997 (megjithëse rezultoi i regjistruar në organet tatimore vetëm në periudhën 1.1.1997 – 31.12.1997, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ushtron aktivitetin si avokat, me datë krijimi 10.10.1996) dhe, për pasojë, Komisioni nuk ka mundur të konsiderojë të ardhura për këtë periudhë në analizën financiare.

8.17 Komisioni kreu analizën financiare të subjektit të rivlerësimit duke marrë në konsideratë kursime të mundshme të tij nga paga si gjyqtar për periudhën nëntor 1997 – dhjetor 2003, nga ku rezultoi se mundësia e tij për kursim është vetëm në vlerën 1,070,572 (një milion e shtatëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

8.18 Në përfundim, lidhur me mundësinë e krijimit të shumës prej 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro të deklaruar në DPV-në e vitit 2003 si kursime *cash* rezultoi i paprovuar burimi për krijimin e kësaj shume sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe e padokumentuar në ndonjë formë apo mënyrë ekzistenca e kësaj shume. Komisioni ngre dyshime se deklaratimet e subjektit janë fiktive/rremë.

Analizë e burimit të të ardhurave për krijimin e gjendjes *cash* 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro

8.19 Referuar deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, kjo shumë është krijuar pas deklaratimit të parë në vitin 2003 dhe në vazhdim. Për llogaritjen e mundësive financiare do të merren në vlerësim: (a) të ardhurat nga puna si gjyqtar për periudhën 1.1.2004 – 24.4.2015 kur është depozituar në llogarinë bankare; (b) të ardhurat e ish-bashkëshortes si avokate në periudhën 2003 – 2011 dhe notere në periudhën 2011 – 2012 (divorcuar në korrik të vitit 2012); dhe (c) trashëgimia e babait (ndërruar jetë në korrik të vitit 2011).

8.20 Gjatë kësaj periudhe (2004 – 2015) subjekti i rivlerësimit ka qenë subjekt deklarues, prandaj do të merren në vlerësim edhe DPV-të, në të cilat subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga puna e tij dhe ish-bashkëshortes ndër vite, si dhe shtim të gjendjes *cash*, të cilat janë pasqyruar në analizën financiare sipas deklaratimeve të subjektit, përkatësisht, për çdo vit dhe mundësive të tyre për krijimin e të ardhurave sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës (referuar dokumentacionit përkatës).

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2020, e QKB-së.

8.21 QKB-ja ka konfirmuar²² për ILDKPKI-në se ish-bashkëshortja (Xh. O.) e subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar si Person Fizik me NIPT ***. Sipas ekstraktit historik të dërguar nga QKB-ja, shtetasja Xh. O. është regjistruar si Person Fizik në datën 20.9.2007, fillimisht, me objektin e veprimtarisë si avokat dhe nga data 29.6.2011 si notere.

i. Në DPV-në e vitit 2004: të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe gjendje cash të mbartur, të deklaruar nga bashkëshortja në DIPV-në e vitit 2003, në shumën 800,000 (tetëqind mijë) lekë. Në vitin 2004 nuk deklarohet të ardhura të realizuara nga bashkëshortja.

ii. Në DPV-në e vitit 2005: të ardhura nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit, nuk deklarohet të ardhura nga bashkëshortja.

iii. Në DPV-në e vitit 2006: të ardhura nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit, nuk deklarohet të ardhura nga bashkëshortja.

iv. Në DPV-në e vitit 2007: (a) të ardhura nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhura nga puna e bashkëshortes si avokate deklaruar në shumën 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë; (b) shtesë në gjendjen *cash* nga puna e bashkëshortes si avokate në shumën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë.

Shpjegim: Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion provues lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i ish-bashkëshortes në vitin 2007. Sipas dokumentacionit që Komisioni disponon, bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar xhiro për vitin 2007 dhe nuk rezultojnë taksa të paguara dhe deri në këtë moment këto të ardhura nuk do të merren në konsideratë në analizën financiare.

v. Në DPV-në e vitit 2008: (a) të ardhura nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhura nga puna e bashkëshortes si avokate, deklaruar në shumën 1,950,000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë; (b) gjendje *cash* e deklaruar nga të ardhurat e pagës dhe të bashkëshortes në shumën 2,000,000 (dy milionë) lekë.

Shpjegim: DRT-ja Tiranë ka konfirmuar²³ për ILDKPKI-në se për vitin 2008 ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka realizuar xhiro totale në shumën 1,470,000 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, fitimi i realizuar është 0 (zero) lekë dhe për këtë vit ka rezultuar me humbje në shumën - 329,142 (treqind e njëzet e nëntë mijë e njëqind e dyzet e dy) lekë, deri në këtë moment këto të ardhura nuk do të merren në konsideratë në analizën financiare.

vi. Në DPV-në e vitit 2009: (a) të ardhura nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhura nga puna e bashkëshortes si avokate, deklaruar në shumën 1,950,000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë; (b) gjendje *cash* e deklaruar nga të ardhurat e pagës dhe të bashkëshortes në shumën 2,000,000 (dy milionë) lekë.

Shpjegim: DRT-ja Tiranë ka konfirmuar²⁴ për ILDKPKI-në se për vitin 2009 ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka realizuar xhiro totale në shumën 1,950,000 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe fitimi i realizuar është në shumën 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë. Këto të ardhura (paga e bashkëshortes dhe fitimi i deklaruar në organin tatimor) janë marrë në konsideratë në analizën financiare.

vii. Në DPV-në e vitit 2010: (a) të ardhura nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhura nga puna e bashkëshortes si avokate, deklaruar në shumën 935,000 (nëntëqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë; (b) gjendje *cash* e deklaruar nga të ardhurat familjare në shumën 1,150,000 (një milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Shpjegim: DRT-ja Tiranë ka konfirmuar²⁵ për ILDKPKI-në se për vitin 2010 ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka realizuar xhiro totale në shumën 930,000 (nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë dhe fitimi i realizuar është në shumën 600,000 (gjashtëqind mijë) lekë.

²²Shkresë nr. *** prot., datë 2.8.2017, e QKB-së në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

²³Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2017, e DRT-së Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2017, e DRT-së Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

²⁵Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2017, e DRT-së Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

Këto të ardhura (paga e bashkëshortes dhe fitimi i deklaruar në organet tatimore) janë marrë në konsideratë në analizën financiare.

viii. Në DPV-në e vitit 2011: (a) të ardhurat nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat nga puna e bashkëshortes nga aktiviteti privat, deklaruar në shumën 1,331,560 (një milion e treqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë; (b) në këtë vit subjekti i rivlerësimit deklaroi gjendje *cash* në banesë nga trashëgimia e babait në shumën 700,000 (shtatëqind mijë) lekë (50% e shumës 1,400,000 lekë).

Shpjegime:

a) Lidhur me të ardhurat e ish-bashkëshortes, DRT-ja Tiranë ka konfirmuar²⁶ për ILDKPKI-në se për vitin 2011 ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka realizuar xhiron totale në shumën 1,616,717 (një milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë dhe fitimi i realizuar është në shumën 1,331,558 lekë. Deklarimi në DIPV-në e vitit 2011 përputhet me informacionin e dërguar nga DRT-ja Tiranë.

b) Në DIPV-në e vitit 2011 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në shumën 700,000 lekë nga trashëgimia e babait (50% e shumës 1,400,000 lekë). Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar vendimin nr. ***, datë 21.12.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë mbi lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të z. F. O., i cili ka ndërruar jetë më 11.7.2011. Sipas këtij vendimi, trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të trashëgimlënësit janë përkatësisht: E. O. – bashkëshortja dhe Kreshnik Omari – i biri, të cilët trashëgojnë nga ½ pjesë secili të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme.

c) I pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e të ardhurave të babait që kanë shërbyer për krijimin e shumës *cash* prej 1,400,000 lekësh, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Në dijeninë time, të ardhurat e babait tim kanë qenë puna e tij si inxhinier elektrik në shtet, si përkthyes librash, si shkrimtar librash dhe artikujsh shkencorë, si lojtar, trajner dhe arbitër shahu me titull mjeshër sporti, konsulenca private në fushën e inxhinierisë elektrike, pensioni, si dhe paratë që kam dërguar unë herë pas here gjatë kohës së emigracionit”*.

ç) Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar asnjë dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij për krijimin e shumës *cash* prej 1,400,000 lekësh, nga e cila subjekti i rivlerësimit ka përfituar 700,000 (shtatëqind mijë) lekë, prandaj Komisioni nuk ka marrë në konsideratë deri në këtë moment këto të ardhura si burim për krijimin e gjendjes *cash*.

ix. Në DPV-në e vitit 2012: të ardhura nga paga si gjyqtar e subjektit të rivlerësimit, i cili nuk deklaroi të ardhura nga ish-bashkëshortja dhe shtim të gjendjes *cash*, pasi rezultoi se në këtë vit kanë zgjidhur martesën.

Shpjegime:

a) Nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur deklaratës *Vetting* është depozituar vendimi nr. ***, datë 11.7.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesë subjektin e rivlerësimit dhe ish-bashkëshorten e tij, të cilët kanë kërkuar zgjidhjen e martesës, ku në përfundim, gjykata ka vendosur të pranojë kërkesën duke miratuar aktmarrëveshjen e datës 5.7.2012, zgjidhjen e martesës dhe detyrimin e subjektit të rivlerësimit të paguajë për fëmijën e tij, detyrimin ushqimor në shumën 25,000 lekë/muaj.

b) Në korrik të vitit 2012, ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka aplikuar pranë “Union Bank” për kredi në shumën 40,000 (dyzet mijë) euro (35,000 euro shtëpia + 5,000 euro mobilim), me afat maturimi 25 vjet, me referencë: ***, me qëllim blerjen e një apartamenti banimi me sip. 96.8 m², në rrugën “***”, Tiranë, nga shoqëria “****” sh.p.k., për shumën totale prej 70,000 (shtatëdhjetë mijë) euro.

²⁶Shkresë nr. *** prot., datë 12.9.2017, e DRT-së Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së (Aneks ***).

c) Sipas aplikimit rezulton se shtetasja Xh. O., sipas Kontratës së Sipërmarrjes së datës 9.7.2012 ka paguar ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro. Kjo shumë është fituar nga divorci me subjektin e rivlerësimit, nga e cila shuma prej 20,000 (njëzet mijë) euro përbënte pjesën e saj nga shtëpia ku jetonte me subjektin e rivlerësimit dhe shuma prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro është paguar nga subjekti i rivlerësimit për vajzën e tyre.

x. Në DPV-të për vitet 2013, 2014 dhe 2015, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtim/pakësim (ndryshime) të gjendjes *cash* në shtëpi, ndërsa të ardhurat kanë qenë nga paga si gjyqtar.

8.22 Vlera prej 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro është reflektuar në analizën financiare të vitit 2012 si shpenzim.

8.23 Komisioni përgatiti analizën financiare për datën 1.1.2004, datën e krijimit të depozitës (llogari rrjedhëse) 24.4.2015, nga ku rezulton se është në pamjaftueshmëri financiare për derdhjen e shumës prej 135,999 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) euro pasi ka: (a) për shumën 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro minus në vlerën 11,893,478 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë; dhe (b) për shumën 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro minus në vlerën 7,300,877 (shtatë milionë e treqind mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë).

8.24 Në total, subjekti rezulton në pamjaftueshmëri financiare për krijim e kësaj depozite në datën 24.4.2015.

8.25 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj shume të derdhur në bankë në vitin 2015.

8.26 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar lidhur me burimet sa vijon:

a) Subjekti ka përcjellë dokumentacion lidhur me burimin e krijimit të shumës prej 97,000 euro nga emigracioni: “... gjithsej nëpërmjet punës në Itali kam marrë në total sipas llogaritjeve rreth 167,762,348 liretta. Dokumentet që vërtetojnë pagesat, të përkthyer dhe të noterizuara jua vë në dispozicion”.

Kompania	Vlera
***	3.800.000 liretta
Zdruktari	1.300.000 liretta
***	5.200.000 liretta.
***	24.000.000 liretta.
***	90.562.348 liretta
***	43 000 000 liretta

8.26.1 Komisioni ka marrë në konsideratë dokumentacionin e përcjellë në prapësime nga subjekti i rivlerësimit, nga të cilat rezultoi se vetëm shuma prej 76,064,077 liretta (ekuivalent i shumës 39,283 euro) verifikohet me dokumentacion përkatës ligjor, krahasuar me shumën 167,862,348 liretta, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

Kompania	Vlera sipas SR	Vlera e dokumentuar
***	3.800.000	1.760.377

Zdrukhtari	1.300.000	0
***	5.200.000	0
***	24.000.000	8.468.787
***	90.562.348	65.834.913
***	43.000.000	0
Totali në liretta	167.862.348	76.064.077
Ekivalent euro ²⁷	<u>€ 86.693</u>	<u>€ 39.283</u>

8.26.2 Nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor krijimin e gjendjes *cash* 97,000 euro nga emigracioni, pasi vlera e provuar e të ardhurave *neto* gjatë periudhës 1991 – 1995 është vetëm shuma prej 39,283 (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) euro, pa marrë në konsideratë vlerën e shpenzimeve të jetesës gjatë kësaj periudhe.

8.26.3 Komisioni ka përgatitur analizë me rezervë, duke konsideruar të ardhura prej 40,000 (dyzet mijë) euro, si burim nga emigracioni, ku rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në vlerën 6,547,478 (gjashtë milionë e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.

Analizë nëntor 1997 - dhjetor 2003		Analizë me rezervë
Të ardhura në total	2.650.722	7.996.722
Shpenzime në total	1.230.150	1.230.150
Pasuri të krijuara (automjet tip “Lancia Theme”)	350.000	350.000
Shtesa cash (EUR 97K)	12.964.050	12.964.050
Rezultati	-11.893.478	-6.547.478

8.26.4 Lidhur me gjendjen *cash* prej 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro, subjekti ka dhënë shpjegime gjatë seancës dëgjimore mbi shumën prej 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) euro, të llogaritur nga Komisioni si shpenzim në analizën financiare.

8.26.5 Subjekti i rivlerësimit shpjegon se shuma e dhënë ish-bashkëshortes së tij është vetëm vlera 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro si shpenzime për vajzën e tij, ndërkohë shuma prej 20,000 (njëzet mijë) euro është fond i ish-bashkëshortes, i sjellë prej saj para martesë dhe të poseduara prej saj pas divorcit, pasi nuk është konsideruar si pasuri e përbashkët.

8.26.6 Gjatë seancës dëgjimore subjekti ka pretenduar një depozitë të ish-bashkëshortes në vlerën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) lekë në “ProCredit Bank”, të krijuar me burim nga dhurimi i vëllait të saj (fonde të marra si dëmshpërblim si i përndjekur politik), të cilën e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004. Subjekti shpjegon se këtë depozitë e ka mbajtur në posedim ish-bashkëshortja pas divorcit.

8.26.7 Nga dokumentacioni i përcjellë rezulton se ka ekzistuar depozita në vlerën 1,100,000 lekë çelur në vitin 2004 në “ProCredit Bank” nga shtetasja Xh. O., e cila është rinovuar deri në vitin 2008 dhe, për më tej, nuk rezulton vazhdimësi e kësaj depozite. Duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit për shumën 20,000 (njëzet mijë) euro, të krijuar nga ish-bashkëshortja me të ardhura para martesë, në analizën financiare është konsideruar si shpenzim i vitit 2012 vetëm vlera 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.

²⁷Convert 76,064,077 Italian Lira to Euro - Live ITL to EUR Exchange Rates | Xe.

8.26.8 Subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale nga ish-bashkëshortja, e cila citon xhiron vjetore të kryer nga aktiviteti i saj në vitet 2007 - 2011. Ky dokument nuk provon fitimin e realizuar nga aktivitetit i noterisë dhe nuk sjell ndryshim të rezultatit të të ardhurave *neto* të realizuara nga ish-bashkëshortja, të pasqyruar në analizën financiare të Komisionit.

8.26.9 Komisioni ka kryer analizën financiare duke marrë në konsideratë si shpenzim vlerën prej 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, nga e cila rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në vlerën 2,215,859 lekë për të krijuar gjendjen *cash*, deklaruar prej tij në vlerën 38,000 (tridhjetë e tetë mijë) euro.

<i>Analizë janar 2004- 24 prill 2015 (prapësime)</i>	
Të ardhura në total	14.451.943
Shpenzime në total	10.444.211
Pasuri të krijuara	2.249.606
Pakësim likuiditetesh në bankë	(1.048.620)
<i>Mundësia për kursime</i>	2.806.745
Gjendje <i>cash</i> deklaruar nga SR (EUR 38K)	5.022.604
<i>Rezultati</i>	-2.215.859

8.27 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e depozitës bankare **në shumën 135,019 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëmbëdhjetë) euro**, çelur në datën 24.4.2015 në “Raiffeisen Bank”. Ai ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

9. Depozitë bankare në “ProCredit Bank” në shumën 1,000,000 (një milion) lekë, krijuar në vitin 2003. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim të krijimit të depozitës: (a) të ardhurat nga puna për 5 vjet si emigrant në Itali në periudhën 1991 – 1995; (b) të ardhurat si avokat për periudhën 1995 – 1997; (c) të ardhurat nga puna si gjyqtar në periudhën 1997 – 6.5.2003.

9.1 Nga analiza e lëvizjeve të llogarisë, kjo depozitë qysh prej krijimit prill 2003 ka qenë në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, e cila është rinovuar ndër vite duke u tërhequr ose kapitalizuar interesi sipas rastit. Në fund të vitit 2016 kjo depozitë ka pasur vlerën 1,194,693 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

9.2 Në DPV-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitën bankare në “ProCredit Bank” në shumën 1,000,000 (një milion) lekë. Burim krijimi: të ardhurat nga puna si emigrant, avokat dhe gjyqtar.

9.3 Burimi i të ardhurave për krijimin e kësaj depozite janë të njëjtat me burimin e të ardhurave për krijimin e gjendjes *cash* 97,000 (nëntëdhjetë e shtatë mijë) euro, të trajtuar në pasurinë nr. 8 më sipër, nga e cila subjekti rezulton në pamjaftueshmëri për krijimin e tyre sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

9.4 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar lidhur me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj depozite, e cila është hapur rreth 5 vjet pasi ushtronte funksionin e gjyqtarit. Duket e dyshimtë se pse subjekti ka mbajtur shumat e pretenduara *cash* në shtëpi prej vitit 1997 (apo edhe më herët) dhe në një moment ka krijuar këtë depozitë vetëm me një pjesë të tyre.

9.5 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur të njëjtat shpjegime lidhur me të ardhurat nga emigracioni, trajtuar në pikën 8 më lart, në vendim, si dhe ka shpjeguar se hapja e depozitës në një kohë të më vonshme e vetëm për një pjesë të të ardhurave lidhej me sigurinë e sistemit bankar dhe garancitë që ofronte.

9.6 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj depozite, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe se ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10. Dy llogari bankare në shumat 1,000,000 (një milion) lekë dhe 500,000 (pesëqind mijë) lekë, në “ProCredit Bank”, që janë në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, nga të cilat trashëgon 50%. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *Vetting*, deklaroi si burim krijimi trashëgiminë nga babai, i cili ka ndërruar jetë në vitin 2011.

10.1 Subjekti i rivlerësimit, me vendim gjykate për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, është caktuar trashëgimtar ligjor i radhës së parë së bashku me nënën e tij, duke trashëguar secili nga ½ pjesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme.

10.2 Referuar shkresës së “ProCredit Bank” rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur 2 llogari bankare pranë kësaj banke, të hapura përkatësisht në datën 3.6.2009 në vlerën 500,000 (pesëqind mijë) lekë dhe në datën 12.2.2011 në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë, të cilat ende vazhdojnë të jenë në emër të babait të subjektit të rivlerësimit. Këto llogari bankare janë hapur nga shtetasi F. O. dhe subjekti i rivlerësimit ka qenë person i autorizuar për të kryer veprime në këtë llogari. Nga vlerësimi i *statement*-it bankar rezulton se:

- a) Shuma prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh është depozituar *cash* në bankë nga shtetasi F. O. në datën 3.6.2009 dhe është çelur depozitë me afat 1-vjeçar në të njëjtën datë.
- b) Shuma prej 1,000,000 (një milion) lekësh është depozituar *cash* në bankë nga shtetasi F. O. në datën 12.2.2011 dhe është çelur depozitë me afat 1-vjeçar në të njëjtën datë.
- c) Rezulton se pas vdekjes së shtetasit F. O. në korrik të vitit 2011, këto depozita nuk janë rinovuar, por shumat përkatëse kanë kaluar në llogari kursimi me interes, shuma e të cilave në fund të vitit 2016 është në vlerën 1,637,522 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e njëzet e dy) lekë.

10.3 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e krijimit të dy depozitave bankare pranë “ProCredit Bank” në shumat 1,000,000 (një milion) lekë dhe 500,000 (pesëqind mijë) lekë, shprehet se: *“Në dijeninë time, të ardhurat e babait tim kanë qenë puna e tij si inxhinier elektrik në shtet, si përkthyes librash, si shkrimtar librash dhe artikujsh shkencore, si lojtar, trajner dhe arbitër shahu me titull mjeshtrë sporti, konsulenca private në fushën e inxhinierisë elektrike, pensioni, si dhe paratë që kam dërguar unë herë pas here gjatë kohës së emigracionit”*.

10.4 Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij për krijimin e dy depozitave bankare pranë “ProCredit Bank” në shumat 1,000,000 (një milion) lekë dhe 500,000 (pesëqind mijë) lekë, nga të cilat, pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit është 50%.

10.5 Mbetet i pa provuar burimi i krijimit të kësaj pasurie nga babai i subjektit të rivlerësimit. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provonte burimin e krijimit të këtyre depozitave nga babai i tij.

10.6 Në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk e konsideroj veten si person të lidhur me babanë tim, për efekt të këtij ligji, pasi nuk ka pasur asnjë marrëdhënie interesi mes nesh. Rrjedhimisht, përveç vështirësisë objektive (për faktin se im atë ka ndërruar jetë) mendoj se nuk kam detyrim ligjor për të provuar mënyrën dhe burimet e krijimit të pasurive që i përkasin atij”*.

10.6.1 Gjatë shpjegimeve lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij, subjekti shprehet se: *“... të ardhurat e babait tim kanë qenë puna e tij si inxhinier elektrik në shtet, si përkthyes librash, si shkrimtar librash dhe artikujsh shkencorë, si lojtar, trajner dhe arbitër shahu me titull mjeshtrë sporti, konsulenca private në fushën e inxhinierisë elektrike, pensioni,*

dëshmëpërblim për të përndjekurit politikë, si dhe paratë që kam dërguar unë herë pas here gjatë kohës së emigracionit”.

10.6.2 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktekspertimin për të ardhura të mundshme të përfituara nga babai nga aktiviteti privat (honorare/konsulenca/projektim/dëshmëpërblim) për vitet 1993 – 2010, në vlerën 45,000 (dyzet e pesë mijë) euro. Subjekti shprehet se si të ardhura zyrtare mund të paraqesë ato që ka siguruar nga DRSSH-ja, kurse për të ardhurat nga aktiviteti i ushtruar nuk mund të paraqesë dokumentacion, pasi nuk kanë qenë të regjistruar në organet tatimore për aktivitetin e ushtruar.

10.7 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave, trupi gjykues vlerëson se babai i subjektit mund të ketë pasur të ardhura nga shërbimet e kryera, por nuk provohet me asnjë dokumentacion provues përfitimi i tyre dhe nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore, pasi nuk ka qenë i regjistruar në organet përkatëse tatimore. Në vijim të kësaj logjike, si dhe faktit se kanë jetuar në një banesë pavarësisht se kanë qenë të ndarë në gjendjen civile, trupi gjykues ka vlerësuar se ishte e rëndësishme që subjekti të paraqiste prova lidhur më së paku me faktin se të ardhurat vinin nga një burim i ligjshëm. Në vlerësim të rrethanave dhe praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nisur edhe nga fakti se këto të ardhura nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie, trupi gjykues ka pranuar shpjegimet e subjektit duke mos e rënduar situatën e tij edhe për këto pasuri të trashëguara.

GJETJE TË TJERA

17. Kalim në llogari të nënës së subjektit të rivlerësimit të shumës 160,000 euro, nga shoqëria “**” sh.p.k., sipas Deklaratës Noteriale të datës 12.2.2015**

17.1 Komisioni ka kërkuar²⁸ nga noteri vënie në dispozicion të praktikës²⁹, nga e cila rezulton se:

a) Në datën 11.2.2010, midis shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, në cilësinë e sipërmarrësit dhe babait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit F. O., në cilësinë e porositësit, është lidhur Kontrata e Sipërmarrjes e datës 11.2.2010 (jo noteriale), lidhur me prenotimin e një “njësie” (dyqani), me sipërfaqe 183.3 m², me sipërfaqe të përbashkët 14.7 m², me sipërfaqe ndërtimi totale 198 m², me adresën rruga “****”, kundrejt çmimit prej 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro, i cili do paguhej me mandatarkëtim pranë shoqërisë me 6 këste.

b) Këstet për blerjen e njësisë janë paguar *cash* nga babai i subjektit të rivlerësimit pranë shoqërisë me mandatarkëtimet përkatëse, sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes plotësisht.

c) Në datën 25.6.2011, midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe babait të subjektit të rivlerësimit është nënshkruar “Revokimi i Kontratës së Sipërmarrjes datë 11.2.2010” (jonoteriale), sipas së cilës revokohet Kontrata e Sipërmarrjes së datës 11.2.2010, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme: *“Palët, shoqëria ‘****’ sh.p.k., me ortak të vetëm z. V. I. dhe shtetasi F. O., me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë kanë rënë dakord që shumën 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë euro, për revokimin e kontratës, meqenëse shoqëria ka mungesë likuiditeti t’i paguajë brenda vitit 2014, duke ia derdhur pagesat në numrin e llogarisë bankare të porositësit”.*

ç) Në bazë të Deklaratës Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.2.2015, Administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, shtetasi V. I., ka deklaruar, ndër të tjera, si vijon: *“... në datën 11.2.2010, është lidhur dhe nënshkruar një kontratë sipërmarrje me shtetasin F. O., për blerjen e një ‘njësie dyqan’, me sipërfaqe ndërtimi totale 198 m², në shumën 160,000 euro, me adresë rr. ‘****’, shumë e cila është likuiduar me këste me mandatarkëtim pranë shoqërisë nga blerësi. Në datën 25.6.2011, palët me marrëveshje ndërmjet njëri-tjetrit kanë revokuar*

²⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2021.

²⁹Deklaratës noteriale të datës 12.2.2015.

*kontratën e sipërmarrjes dhe kemi rënë dakord për të kthyer shumën e mësipërme ndërmjet bankës. Sot me anë të kësaj deklarate unë V. I., ortak i vetëm i shoqërisë “***” sh.p.k., deklaroj se e kam shlyer të gjithë shumën prej 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro, nëpërmjet bankës në numrin e llogarisë të bashkëshortes së të ndjerit F. O., znj. E. O..”.*

d) Bashkëlidhur Deklaratës Noteriale dhe praktikës referuese është dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 21.12.2011, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së babait të subjektit të rivlerësimit dhe caktimi i tij dhe nënës si trashëgimtarë të radhës së parë.

17.2 Referuar sa më sipër, konstatohet se trashëgimtarë të të ndjerit F. O., janë subjekti i rivlerësimit dhe nëna me ½ pjesë secili. Pagesa prej 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro është derdhur/kaluar për llogari të nënës së subjektit në BKT në datën 12.2.2015 (megjithëse edhe për shoqërinë “****” sh.p.k., ka qenë e qartë nga vendimi i gjykatës bashkëlidhur deklaratës noteriale të datës 12.2.2015, se trashëgimtar i radhës së parë është edhe subjekti i rivlerësimit).

17.3 Në vijim, në datën 8.5.2015, nëna e subjekti rivlerësimit kalon shumën prej 60,000 euro në një llogari të përbashkët me shtetasen V. P. në po të njëjtën bankë. Shtetasja V. P. në datën 27.11.2015 kalon shumën prej 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) euro në një llogari të saj personale në po të njëjtën bankë.

17.4 Nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se shuma prej 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) euro ka qëndruar në llogarinë e shtetasen V. P. deri në vitin 2017. Shtetasja V. P. nga hetimi rezulton person tjetër i lidhur me subjekti rivlerësimit, si dhe në lidhje të vazhduar miqësore me të.

17.5 Vlera prej 100,000 (njëqind mijë) euro në llogarinë personale të nënës së subjekti rivlerësimit është përdorur në vijim në datën 27.11.2015, për një kontratë të lidhur me investitor G. A. në Vlorë/Orikum në vitin 2016, të trajtuar në vijim, duke kaluar me bankë vlerën prej 16,600 (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro. Shuma e mbetur prej 83,400 (tetëdhjetë e tre mijë e katërqind) euro për likuidimin e kontratës, është mbajtur në llogari deri në vitin 2018, kur edhe është transferuar për blerjen e një pasurie apartament me sip. 134 m² në “****”, në ndërtim nga shoqëria “****” sh.p.k., e trajtuar në vijim të këtij relacioni.

17.6 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur³⁰ nga Komisioni, lidhur me këtë transaksion, me vonesë është shprehur se: *“Asnjë nga transaksionet, kontratat apo sendet e paluajtshme të përmendura në pyetjet tuaja nuk ka lidhje me personin tim, nuk bëjnë pjesë në pasuritë e deklaruara apo të poseduara nga unë dhe, rrjedhimisht, nuk kam dokumente lidhur me sa më sipër”.*

17.7 Subjekti i rivlerësimit, i ripyetur përsëri nga Komisioni lidhur me transaksionet me shtetasen V. P., shprehet se: *“Me V. P.n kam pasur shoqëri dhe miqësi familjare. Transaksioni bankar të cilit i referoheni dhe që është kryer nga nëna ime (transaksion për të cilin erdha në dijëni nëpërmjet e-mail-it tuaj pararendës), nuk lidhet me para që më përkasin mua”.*

17.8 Shuma prej 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro, e paguar nga babai i subjektit të rivlerësimit për prenotimin e një “njësie” (dyqan) te shoqëria “****” sh.p.k. dhe revokuar më pas, i përket sipas dëshmisë së trashëgimisë, pjesë edhe e praktikës mbi kthimin e shumës 50% subjektit të rivlerësimit.

17.9 Në bazë të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.* Referuar transaksionit të mësipërm, rezulton se midis subjektit të rivlerësimit dhe babait shtetasit F. O. dhe nënës shtetasen E. O., ka pasur lidhje interesi dhe, për këtë shkak, konsiderohen nga ligji si persona të tjerë të lidhur dhe, për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur, kanë detyrimin për të

³⁰Shihni përgjigjen e pyetësorit datë 7.4.2021.

justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Edhe shtetasja V. P. ndodhet në kushtet e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

17.10 Komisioni hetoi lidhur me konflikte të mundshme të interesit mes subjekti të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese nga e cila nuk rezultuan të dhëna.

17.11 Lidhur me këtë pasuri, rezulton se:

a) Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë burimin e krijimit të kësaj pasurie nga babai i tij në vitin 2010-2011, si dhe duhet të sqarojë lidhur me transfertat e kryera pas përfitimit nëpërmjet kthimit të shumës nga ndërtuesi.

b) Shuma prej 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro i është kaluar nga shoqëria “****” sh.p.k., vetëm nënës së subjektit të rivlerësimit, në një llogari të hapur para pak ditësh dhe në të cilin është kryer vetëm transaksion dhe veprimet pasrendëse të shpjeguara më lartë. Nëna e subjektit të rivlerësimit ka kaluar shumën prej 60,000 (gjashtëdhjetë mijë) euro në një llogari të përbashkët me shtetasen V. P. (person në lidhje të afërt me subjektin e rivlerësimit) të krijuar/hapur në të njëjtën periudhë kohore, ku kjo e fundit e ka kaluar në vijim në llogari personale, po ashtu, të krijuar/hapur në këtë periudhë kohore.

c) Duket se subjekti i rivlerësimit fsheh blerjen e këtyre pasurive dhe kryerjen e veprimeve bankare për të cilat Komisioni ngre dyshime se janë pasuri e fshehur e subjektit.

ç) Subjekti i rivlerësimit ishte trashëgimtar ligjor i pasurive të babit të tij dhe duhet të deklaronte në DIPV-në e vitit 2015 këtë pasuri.

d) Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëpunuar me Komisionin, duke mos depozituar dokumentacion dhe mos dhënë shpjegimet e kërkuara lidhur me këtë pasuri.

17.12 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar e provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

17.13 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti shpjegon se: *“Nuk e konsideroj veten si person të lidhur me prindërit e mi për efekt të këtij ligji, pasi nuk ka pasur asnjë marrëdhënie interesi mes nesh. Rrjedhimisht, përveç vështirësisë objektive (pasi pasuritë e tyre ju përkasin atyre, si dhe për faktin se im atë ka ndërruar jetë), mendoj se nuk kam detyrim ligjor për të provuar mënyrën dhe burimet e krijimit të pasurive që u përkasin atyre. Gjithsesi, e ndjej si detyrim moral ndaj prindërve, për të hequr çdo hije dyshimi rreth figurës së tyre të nderuar, të shpjegoj se në dijeninë time, të ardhurat e prindërve kanë qenë për babanë puna e tij si inxhinier elektrik në shtet, si përkthyes librash, si shkrimtar librash dhe artikujsh shkencore, si lojtar, trajner dhe arbitër shahu me titullin ‘mjeshtër sporti’, konsulenca private në fushën e inxhinierisë elektrike, pensioni, dëmshtëpërblim për të përndjekurit politike, si dhe paratë që kam dërguar unë, herë pas herë, gjatë kohës së emigracionit dhe të ardhurat për nënën time kanë qenë puna e saj si dentiste në shtet, si dhe puna e saj si dentiste privatisht nga viti 1991 – 2004. Të ardhura zyrtare për ta mund të paraqes ato që kam mundur të siguroj nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, kurse për të ardhurat nga aktivitetet e ushtruara prej tyre privatisht (nëna si dentiste për rreth 13 vjet dhe babai me projekte në fushën e projekteve të sistemeve elektrike te pallateve te reja, botimet, përkthimet etj.), nuk jam në gjendje të paraqes dokumente, pasi nuk kanë qenë të regjistruar në organet tatimore për aktivitetin e ushtruar prej tyre”.*

17.4 Subjekti është shprehur se nuk është trashëgimtar ligjor i shumës prej 160.000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro, pasi kjo shumë mund të jetë edhe kursime të nënës së tij të cilat janë përdorur nga babai për blerjen e pasurisë “njësi”, në vitin 2010, pavarësisht se kontrata dhe mandatpagesat janë firmosur nga babai i tij.

17.5 I pyetur në seancën dëgjimore, lidhur me shumën dhënë shtetasen V. P. nga nëna e tij me burim, pikërisht këto të ardhura, subjekti është shprehur se nuk është person i lidhur me nënën e tij dhe se lidhja e saj me shtetasen V. P. është një lidhje mes tyre, “mbase ajo ia ka dhënë hua”, citon subjekti.

17.6 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit është trashëgimtar ligjor i babait të tij dhe, për pasojë, edhe i pjesës takuese në këtë pasuri të përfituar pas vdekjes së tij. Nëse ai do të kishte vlerësuar t'ia linte nënës së tij, duhet të kishte hequr dorë nga kjo e drejtë. E dyshimtë për Komisionit mbetet edhe transferata bankare e kryer mes nënës së subjektit të rivlerësimit dhe shtetasës V. P., e cila edhe gjatë hetimeve të Komisionit ka rezultuar person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, të paktën deri në vitin 2016.

17.7 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe se nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, prandaj duhet të zbatohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

18. Nga DPPP-ja rezulton se nëna e subjektit të rivlerësimit, shtetasja E. O., ka lidhur kontratën e qirasë për apartament + vend barke dhe përdorim i shërbimeve portuale, me datë transaksioni 3.5.2016, me vlerë transaksioni 99,600 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) euro.

18.1 Nëna e subjektit të rivlerësimit e datëlindjes 1934, në nëntor të vitit 2015, referuar *statement*-it bankar ka transferuar nga llogaria e saj në BKT, shumën prej 16,600 (gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro në llogari të shoqërisë “***” sh.p.k.

18.2 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur³¹ nga Komisioni lidhur me këtë transaksion, nuk ka depozituar asnjë dokumentacion dhe nuk ka dhënë shpjegime, duke u shprehur se transaksioni, kontrata dhe sendi i paluajtshëm nuk ka lidhje me të, nuk bën pjesë në pasuritë e deklaruara apo të zotëruara prej tij dhe, rrjedhimisht, nuk ka dokumente lidhur me sa më sipër.

18.3 Komisioni kërkoi³² dokumentacionin përkatës nga noteri, nga i cili rezultoi si vijon:

a) Në datën 12.4.2016, shtetasja E. O. në cilësinë e klientit, ka lidhur “kontratë qiraje apartamenti e vendi barke dhe përdorim i shërbimeve portuale – mbi dhjetë vjet”, me shoqërinë “***” sh.p.k., me NIPT ***, me kohëzgjatje deri në datën 22.3.2095.

b) Sipas Kontratës shoqëria i ka dorëzuar klientit në datën e lidhjes së kontratës vendin e varkës për akostimin dhe një varkë me gjatësi maksimale 12 m dhe gjerësi maksimale 3.80 m, si dhe apartamentin 1/21, tipi 2+1, me sipërfaqe 52.7 m², nr. pasuri ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në Vlorë.

c) Në bazë të nenit 3 të Kontratës, klienti ka paguar në favor të shoqërisë vlerën 99,600 (nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) euro (përfshirë 20% TVSH) për gjithë periudhën e qirasë.

18.4 Pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, duke pasur parasysh moshën e nënës së subjektit të rivlerësimit (82 vjeç në momentin e lidhjes së Kontratës) dhe zotërimin e një mjeti Velierë (trajtuar më sipër si pasuria nr. 7) nga subjekti i rivlerësimit blerë në tetor të vitit 2015, duket se kjo kontratë është lidhur për marrjen me qira të një apartamenti dhe të një vendi akostimi varke, si dhe përdorimin e shërbimeve portuale nga subjekti i rivlerësimit për velierën e tij.

18.5 Komisioni hetoi lidhur me konflikte të mundshme të interesit mes subjekti të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese nga e cila nuk rezultuan të dhëna.

18.6 Referuar sa më sipër, lidhur me këtë pasuri:

a) Duket se kontrata e qirasë së apartamentit + vendi varke dhe përdorim i shërbimeve portuale me shoqërinë “***” sh.p.k., e lidhur nga nëna e subjektit të rivlerësimit është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëpunuar me Komisionin, duke mos dhënë shpjegime, si dhe duke mos depozituar dokumentacion provues ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të

³¹Shihni përgjigjen e pyetësorit datë 7.4.2021.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2021.

ardhurave të paguara (99,600 euro), për shkak të marrjen me qira të kësaj pasurie nga nëna e tij.

c) Subjekti rivlerësimit duhet të provojë qëllimin e lidhjes së kësaj kontrate nga nëna e tij dhe burimin e të ardhurave për pagimin e kësaj kontrate shërbimesh [kryesisht të shumës prej 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro, vlera e mbetur], si dhe mënyrën e pagimit të saj, nëse kjo pasuri nuk është “pasuri e fshehur” e vetë subjektit të rivlerësimit apo të provojë të kundërtën e këtij rezultati hetimit.

18.7 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar e provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

18.8 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti ka shpjeguar se:

a) “ *Nuk e konsideroj veten si person të lidhur me prindërit për efekt të këtij ligji, pasi nuk ka pasur asnjë marrëdhënie interesi mes tyre. Gjithsesi, e ndjej si detyrim moral ndaj prindërve, për të hequr çdo hije dyshimi rreth figurës së tyre të nderuar, të shpjegoj se në dijeninë time, të ardhurat e prindërve kanë qenë për babanë nga puna e tij si inxhinier elektrik në shtet, si përkthyes librash, si shkrimtar librash dhe artikujsh shkencore, si lojtar, trajner dhe arbitër shahu me titullin ‘mjeshtër sport’, konsulenca private në fushën e inxhinierisë elektrike, pensioni, dëmshpërblim për të përndjekurit politike, si dhe paratë që kam dërguar unë, herë pas here, gjatë kohës së emigracionit dhe të ardhurat për nënën time kanë qenë nga puna si dentiste në shtet, si dhe puna si dentiste privatisht nga viti 1991 – 2004. Të ardhura zyrtare për ta mund të paraqes ato që kam mundur të siguroj nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore kurse për të ardhurat nga aktivitetet e ushtruara prej tyre privatisht (nëna si dentiste për rreth 13 vjet dhe babai me projekte në fushën e projekteve të sistemeve elektrike të pallateve të reja, botimet, përkthimet etj.) nuk jam në gjendje të paraqes dokumente, pasi nuk kanë qenë të regjistruar në organet tatimore për aktivitetin e ushtruar prej tyre. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktekspertim për të ardhura të mundshme të përfituara nga nëna e tij nga aktiviteti privat si dentiste për vitet 1991- 2004, në vlerën 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro. Subjekti shprehet se si të ardhura zyrtare mund të paraqes vetëm ato që ka siguruar nga DRSSH-ja (pensionet), kurse për të ardhurat nga aktiviteti i ushtruar nga nëna nuk mund të paraqes dokumentacion, pasi nuk kanë qenë regjistruar në organet tatimore për aktivitetin e ushtruar”.*

b) Lidhur me apartamentin e marrë nga nëna e tij, subjekti sqaron: “*Ky apartament është marrë me qira dhe është përdorur prej saj që në verën e vitit 2007 dhe jo në vitin 2016. Në vitin 2016 është bërë kontrata përfundimtare e marrjes me qira, pasi është paguar edhe kësti i fundit, por ndërkohë për apartamentin, pagesat e tjera ishin bërë prej saj që në vitin 2007 dhe 2008, siç rezulton edhe nga vërtetimi i pagesave i lëshuar nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe që i bashkëlidhet kontratës së marrjes me qira. Ju vë në dispozicion kopjen e kontratës prej 47 faqe (gjithsej 48 fletë me gjithë vërtetimin për nxjerrjen nga arkiva noteriale), të cilën nëna ime e tërhoqi posaçërisht nga noteria për të ma vënë mua në dispozicion, ku faqja e fundit përmban certifikatën e pagesave si më poshtë te kryera nga nena ime për marrjen me qira të apartamentit në fjalë.*

- datë 23.7.2007, vlera 74,700 euro;
- datë 21.7.2008, vlera 8,300 euro;
- datë 14.12.2015, vlera 16,600 euro.

c) Lidhur me burimin e shumës së përdorur nga nëna për blerjen e kësaj pasurie, subjekti sqaron se: “*Pagesat janë përballuar nga nëna ime me kursimet e saj. Mesa me shpjegoj nëna ime përveç kursimeve të saj, për marrjen me qira të këtij apartamenti është përdorur edhe shuma prej 90.000 euro që asaj dhe babait tim jua kishte dhënë shtetasi V. I., mik i babait dhe i nënës sime, aktualisht ndërtues, me të cilin kishin bërë një marrëveshje në vitin 2007 që nëse do të privatizohej trualli të ish-*** ku 460 m² i ishin njohur babait tim me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave si trashëgimtar i B. O., do t’i jepej atij e drejta e investimit që do të kryhej mbi këtë truall”.*

18.9 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse dhe se nuk provohet me dokumentacion marrëdhënia midis shtetasit V. I. dhe prindërve të subjektit. Prindërit e subjektit mund të kenë pasur të ardhura nga shërbimet e kryera, por nuk provohet me asnjë dokumentacion provues përfitimit i tyre dhe nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore, pasi nuk ka qenë i regjistruar në organet përkatëse tatimore.

18.10 Në praktiken e dërguar nga noterja pranë Komisionit, mungon deklarata e pagesave të kryera në vitin 2007-2008, në total për vlerën prej 83.000 (tetëdhjetë e tre mijë) euro. Kjo deklaratë, në të cilën konfirmohen pagesat e viteve 2007-2008, është firmosur vetëm nga subjekti shitës shtetasi G. A. dhe është hartuar në dhjetor të vitit 2015 dhe nuk është e noterizuar.

18.11 Paraqitja e këtij dokumenti nga subjekti gjatë seancës dëgjimore sjell dyshime për vërtetësinë e tij pasi: (a) vetë noterja nuk ia ka përcjellë këtë dokument Komisionit gjatë hetimit administrativ; (b) ngrihen dyshime për mënyrën se si është likuiduar vlera *cash* prej 83,000 (tetëdhjetë e tre mijë) euro nga nëna e subjektit në vitet 2007-2008, te shoqëria italiane pa u mbështetur në asnjë dokumentacion provues (kontratë porosie, aktmarrëveshje, mandatpagesë etj.).

18.12 Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka mundur të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe se ka kryer deklarime të ndryshme gjatë hetimit administrativ, duke krijuar bindjen se ka dashur të fshehtë këtë pasuri nga hetimet e kryera nga Komisioni. Në përfundim, trupi gjykues krijon bindjen se kjo është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe se ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

19. Nga DPPP-ja rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi F. O., ka lidhur kontratën e shitblerjes për 2 vendparkime, me datë transaksioni 10.6.2011, me vlerë transaksioni 2,800,000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë

19.1 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni kërkoi³³ nga subjekti i rivlerësimit të provonte me dokumentacion burimin e të ardhurave të babait të tij për blerjen e kësaj pasurie, si dhe depozitim të kontratës së blerjes dhe dokumentacionin përkatës për pagesën e kryer. Subjekti i rivlerësimit shprehet se transaksioni, kontrata dhe sendi i paluajtshëm nuk ka lidhje me të, nuk bën pjesë në pasuritë e deklaruara apo të zotëruara prej tij dhe, rrjedhimisht, nuk ka dokumente lidhur me sa më sipër.

19.2 Komisioni kërkoi³⁴ dokumentacionin përkatës nga noteri, nga i cili rezultoi si vijon:

a) Babai i subjektit të rivlerësimit, përfaqësuar me prokurë nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me cilësinë e palës blerëse, ka lidhur Kontratën Premtim Shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.6.2011, me shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, për blerjen e dy vendparkimeve, në objektin e ndërtuar nga shoqëria në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt çmimit prej 1,400,000 (një milion e katërqind mijë) lekë secili, për një total prej 2,800,000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekë. Babai i subjektit të rivlerësimit, shtetasi F. O., ka vdekur në korrik të vitit 2011 (i datëlindjes 1933).

b) Sipas Kontratës, palët kanë rënë dakord se pala blerëse ka të drejtë t’i zotërojë dhe shfrytëzojë vendparkimet sipas destinacionit, kurse kontrata përfundimtare e shitjes do të lidhet pas regjistrimit të pasurisë në favor të palës shitëse pranë ZVRPP-së Tiranë.

19.3 Sikurse e kemi përmendur më lart, subjekti i rivlerësimit është trashëgimtar i radhës së parë i babait të tij, i cili ka ndërruar jetë në datën 11.7.2011 dhe përfiton ½ pjesë të çdo pasurie të tij. Edhe këto dy pasuri (dy vendparkime) duhet të ishin pjesë e trashëgimisë. Në DPV-e vitit 2012, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar zotërimin e këtyre dy vendparkimeve.

³³Shihni përgjigjen e pyetësorit datë 7.4.2021.

³⁴Shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2021.

19.3 Komisioni hetoi lidhur me konflikte të mundshme të interesit mes subjekti të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese nga e cila nuk rezultuan të dhëna.

19.4 Nga hetimi nuk ka rezultuar se shtetasi F. O. të ketë qenë pronar i ndonjë automjeti. Ai ka qenë i datëlindjes 1933 dhe pensionist prej vitit 1990 dhe relativisht në moshë të madhe. Kontrata Premtim Shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.6.2011, me shoqërinë “****” sh.p.k., është lidhur nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit përfaqësuar me prokurë dhe shtetasi F. O. rezulton se ka ndërruar jetë në datën 11.7.2011.

19.5 Në përfundim, lidhur me këto pasuri, rezulton se:

a) Subjekti rivlerësimit nuk ka deklaruar të drejtat reale të përfituara nga kjo kontratë pas çeljes së trashëgimisë ligjore, në DPV-në e vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting*.

b) Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëpunuar me Komisionin duke mos dhënë shpjegime, si dhe duke mos depozituar dokumentacion provues ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij për krijimin e pasurisë.

c) Komisioni ngre dyshime se këto janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit ose ju duhet të provoni lidhur me burimin e krijimit të tyre dhe qëllimin e babait tuaj për krijimin e këtyre pasurive ndërkohë që nuk ishte pronar i ndonjë automjeti.

19.6 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar e provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

19.7 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar për Komisionin se nuk ka qenë në dijeni të kësaj kontrate. Subjekti citon se: *“Me sa pyeta ish-bashkëshorten time më shpjegoi se ishte paraqitur një okazion nga një klient i saj në kohën që punonte si avokate. Por përfundimisht kontrata e shitjes nuk u krye dhe nuk pati asnjë kalim pronësie të garazheve në fjalë tek babai im”*.

19.8 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti rivlerësimit ka jetuar në një banesë me prindërit e tij dhe se kjo marrëdhënie ishte realizuar prej babit të tij, përfaqësuar me prokurë nga bashkëshortja e subjektit shumë pak kohë pasi ka ndërruar jetë. Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti rivlerësimit nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk e ka ndihmuar Komisionin në hetimet e tij lidhur me këto pasuri, të cilat pas vdekjes së babit duhet t'i kalonin 50% subjektit të rivlerësimit. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues se këto kontrata nuk ekzistojnë më, janë revokuar apo cili është statusi aktual i tyre dhe as nuk është përpjekur të provoje të kundërtën e rezultateve të hetimit.

19.9 Trupi gjykues vlerëson se subjekti rivlerësimit ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germën “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

20. Nga DPPP-ja rezulton se nëna e subjektit të rivlerësimit, shtetasja E. O. e vitlindjes 1934, ka lidhur Kontratën e Porosisë datë 20.6.2018, për pasurinë apartament me sipërfaqe totale prej 134.40 m², në vlerën 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro, me vendndodhje: *, “****”, Tiranë.**

20.1 Komisioni kërkoi³⁵ dokumentacionin përkatës nga noteri, nga i cili rezultoi si vijon:

a) Nëna e subjektit të rivlerësimit, me cilësinë e Porositësit, ka lidhur Kontratën e Porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.6.2018, me shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe totale 134.40 m², nga të cilat 120 m² sipërfaqe banimi dhe 14.40 m² sipërfaqe e përbashkët, për vlerën 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro, në adresën: ***, “****”, Tiranë.

b) Sipas kontratës, pagesa e çmimit të blerjes do të kryhet nëpërmjet transfertës bankare në numrin e llogarisë së shoqërisë në BKT.

³⁵Shkresë nr. *** prot., datë 8.4.2021.

c) Bashkëlidhur kontratës së porosisë është mandati i transferimit të shumës prej 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro nga llogaria e nënës së subjektit të rivlerësimit të shoqëria “****” sh.p.k., datës 20.6.2018, nënshkruar nga nëna e subjektit të rivlerësimit.

20.2 Shuma prej 80,000 (tetëdhjetë mijë) euro (rreth 10,076,000 lekë³⁶), që i është paguar shoqërisë “****” sh.p.k., e ka origjinën nga kalimi në llogari të nënës së subjektit të rivlerësimit të shumës 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro, datë 12.2.2015, nga shoqëria “****” sh.p.k., sipas deklaratës noteriale të datës 12.2.2015, të trajtuar më sipër, ku ka rezultuar se nga kjo shumë subjekti i rivlerësimit duhet të përfitonte ½ pjesë si trashëgimtar ligjor i radhës së parë i babait të tij. Shuma rezulton se i takon në pjesë të barabarta subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij.

20.3 Në bazë të VKM-së nr. 132, datë 7.3.2018, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar, çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren me qëllim banimi, në zonën ku ndodhet apartamenti i porositur nga nëna e subjektit të rivlerësimit, është 107,000 lekë/m².

20.4 Duke pasur parasysh çmimin e mësipërm, rezulton se vlera mesatare referuese e apartamentit të porositur nga nëna e subjektit të rivlerësimit është 14,380,800 (katërmëdhjetë milionë e treqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind) lekë (134.40 m² x 107,000 lekë/m²).

20.5 Çmimi i apartamentit i përcaktuar në Kontratën e Porosisë është dukshëm më i ulët se çmimi mesatar referues i shitblerjes së ndërtesave që përdoren me qëllim banimi, në zonën ku ndodhet apartamenti i porositur nga nëna e subjektit të rivlerësimit.

20.6 Komisioni hetoi lidhur me konflikte të mundshme të interesit mes subjekti të rivlerësimit dhe shoqërisë ndërtuese nga e cila nuk rezultuan të dhëna.

20.7 Kjo pasuri është krijuar pas deklaratës *Vetting*, por ajo lidhet me hetimet e kryera gjatë periudhës së rivlerësimit dhe është një transaksion bankar që është kryer me burim të ardhura gjatë periudhës së rivlerësimit. Po ashtu, nga hetimi duket se kjo pasuri i takon subjektit të rivlerësimit në masën 50% dhe se do të jetë trashëgimtar i kësaj pasurie në vijim.

20.8 Lidhur me këtë pasuri, rezulton se:

a) Duket se subjekti fsheh pjesën e tij takuese në këtë pasuri, si dhe përpiqet të shmangë dhënien e shpjegimeve lidhur me burimin e krijimit të saj.

b) Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë ligjshmërinë e burimit të ardhurave të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, duke depozituar dokumentacion provues ligjor.

c) Duket se çmimi i blerjes së apartamentit është favorizues krahasuar me çmimin mesatar referues të shitblerjes së ndërtesave që përdoren me qëllim banimi, në zonën ku ndodhet apartamenti, si dhe subjekti rivlerësimin ka refuzuar të japë shpjegime për këtë pasuri gjatë hetimit.

ç) Duket se apartamenti është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, nisur nga origjina e të ardhurave të përdoruara, mosha e nënës së tij, si dhe çmimi i shitjes së kësaj pasurie.

20.9 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të shpjeguar e provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

20.10 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për Komisionin se: “*Të gjitha paratë e disponuara nga nëna i përkasin vetëm asaj dhe nuk kanë lidhje me personin tim*”, duke mos dhënë shpjegime të mëtejshme lidhur me këtë pasuri. Trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti rivlerësimin nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka ndihmuar Komisionin në hetimet e tij lidhur me këto pasuri”.

³⁶Sipas Bankës së Shqipërisë kursi mesatar i këmbimit të monedhës euro në lekë për muajin qershor 2018 ka qenë 1 euro = 125.95 lekë.

20.11 Subjekti i rivlerësimit nuk ka bindur trupin gjykues mbi të kundërtën e rezultateve të hetimit. Trupi gjykues vlerëson se subjekti rivlerësimit ndodhet në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

21. Depozitë bankare në “ProCredit Bank”, në shumën 1,000,000 (një milion) lekë në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, shtetas E. O..

21.1 Referuar shkresës së “ProCredit Bank” rezulton se nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur një llogari bankare pranë kësaj banke të hapur në datën 16.6.2003, në vlerën 1,000,000 (një milion) lekë. Kjo llogari bankare është hapur nga shtetasja E. O., me statusin pensionist dhe subjekti rivlerësimit ka qenë person i autorizuar për të kryer veprime në këtë llogari. Nga vlerësimi i statement bankar rezulton se: *“Shuma prej 1,000,000 lekësh është depozituar cash në bankë nga shtetasja E. O. në datën 6.6.2003 dhe është çelur depozitë me afat 1-vjeçar në të njëjtën datë. Kjo depozitë është rinvouar çdo vit prej vitit 2003 deri në vitin 2016, ndërkohë interesat janë akumuluar çdo vit në llogari kursimi. Shuma totale në bankë në fund të vitit 2016 është 1,211,734 lekë”*.

21.2 Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të nënës së tij për krijimin e kësaj depozite bankare pranë “ProCredit Bank” në shumën 1,000,000 (një milion) lekë.

21.3 Mbetet i paprovuar burimi i krijimit të kësaj pasurie nga nëna e subjektit të rivlerësimit. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite.

21.4 Në vijim të rezultateve subjekti ka shpjeguar: *“Nuk e konsideroj veten si person të lidhur me nënën time, për efekt të këtij ligji, pasi nuk ka pasur asnjë marrëdhënie interesi mes nesh. Rrjedhimisht, përveç vështirësisë objektive, mendoj se nuk kam detyrim ligjor për të provuar mënyrën dhe burimet e krijimit të pasurive që i përkasin asaj. Gjithsesi, në dijeninë time, të ardhurat e nënës sime kanë qenë nga puna e saj si dentiste në shtet për rreth 41 vjet (1948 – 1989), nga pensioni, si dhe nga puna si dentiste private për rreth 13 vjet (1991 – 2003)”*.

21.5 Subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues bashkëlidhur.

21.6 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson të mos e trajtojë këtë pasuri të nënës së subjektit të rivlerësimit, në rivlerësimin kalimtar që i bëhet subjektit të rivlerësimit.

22. Depozitë në shumën 1,000,000 (një milion) lekë në “Bankën Italo-Shqiptare”, në emër të shtetasës Xh. O., deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2003. Burimi i krijimit: në deklaratën fillestare të pasurisë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, ap. ***.

22.1 Nga verifikimi *online* i kësaj pasurie në sistemin e ASHK-së, rezultoi se ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë bashkëpronare me 4/9 pjesë në pasuritë e paluajtshme si vijon:

a) apartament me sip. 58.8 m², z. k. ***, nr. pasuri ***, vol. ***, f. ***, në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, regjistruar me nr. ***, datë 15.9.1995;

b) apartament me sip. 58.8 m², z. k. ***, nr. pasuri ***, vol. ***, f. ***, në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, regjistruar me nr. ***, datë 15.9.1995.

22.2 Nga dokumentacioni i marrë nga sistemi i ASHK-së, nuk rezultojnë dokumente për tjetërsimin e apartamenteve, por referuar kartelave të pasurisë, rezulton se kartela e apartamentit me sipërfaqe 58.8 m², nr. pasuri ***, vol. ***, f. ***, në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, është e mbyllur.

22.3 Nga hetimi i lëvizjeve të llogarisë në “Bankën Italo-Shqiptare”, rezulton se kjo depozitë është hapur në datën 6.5.2003 nga ish-bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit dhe martesë e tyre është lidhur më 10.4.2003. Llogaria bankare, gjatë gjithë periudhës deri në zgjidhjen e

martesës (në korrik të vitit 2012) ka mbetur në emër të ish-bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

22.4 Në përfundim, nga hetimi ka rezultuar se kjo llogari është krijuar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit para martesë dhe nuk është përdorur gjatë martesës. Kjo llogari ka mbetur me këtë gjendje edhe pas divorcit me subjektin. Kjo pasuri nuk është konsideruar në vlerësimin e kryer për subjektin e rivlerësimit.

23. Në deklaratën fillestare të pasurisë së vitit 2003, babai i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar pasuritë si vijon:

a) Truall me sip. 460 m², ndodhur në ***, ***, trashëgimi nga babai i tij, njohur me vendimin nr. ***, datë 14.11.1995, të KKKP-së. Pjesa takuese: 100%.

b) Dyqane me sip. 80 m², në *** e ***, trashëgimi nga babai i tij, kthyer dhe njohur me vendimin nr. ***, datë 5.11.1993, të KKKP-së, Bashkia Gjirokastrë. Pjesa takuese: 8.3%.

23.1 Agjencia e Trajtimit të Pronës ka dërguar pranë Komisionit kopje të dosjes nr. ***, datë 24.8.1993, në emër të subjektit të shpronësuar B. O. dhe me kërkues shtetasit Kreshnik dhe F. O., e cila përmban vendimin nr. ***, datë 14.11.1995, të ish-KKKP ish-Pronarëve, Bashkia Tiranë. Lidhur me vendimin nr. ***, datë 5.11.1993, të KKKP-së, Bashkia Gjirokastrë, ATP-ja nuk e ka konfirmuar këtë vendim.

23.2 KKKP-ja Tiranë, pas kërkesës së shtetasve F. dhe L. O., me vendimin nr. ***, datë 14.11.1995, ka vendosur t'i njohë ish-pronarit B. O. pronën e tij dhe t'u kthejë dhe kompensojë trashëgimtarëve të tij pronën si vijon:

a) t'i kompensojë për truallin e zënë me ndërtime shtetërore (Parku i *** dhe Sektori i prodhimit të materialeve të ndërtimit) me sip. 910 m²;

b) t'u njohë të drejtën e parablerjes së parkut të *** sip. 455 m², (Parku i *** me sip. 385 m² dhe sektori i prodhimit të materialeve të ndërtimit) me sip. 70 m².

23.3 Lidhur me këto pasuri, subjekti rivlerësimit nuk shpjegon, ndër vite, ndryshime apo tjetërsime. Subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi në vitin 2011 pas vdekjes së babait përfitim lidhur me këto pasuri. Subjekti nuk i deklaroi këto pasuri në deklaratën *Vetting*, si dhe nuk ka dhënë shpjegime për Komisionin gjatë hetimit administrativ.

23.4 Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit si trashëgimtar ligjor i babait, të deklarojë se çfarë ka ndodhur me këto pasuri dhe pse nuk janë deklaruar ato në deklaratën *Vetting*.

23.5 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se: *“Për sa i përket dyqaneve në Gjirokastrë, ato i kam deklaruar në bazë të të thënave të babait tim, por në dijeninë time nuk di të këtë dyqane të regjistruara në emër të tij.*

*Për sa i përket truallit që ndodhet te ish-***, në dijeninë time iu është njohur trashëgimtareve të B. O. (F. O. dhe L. O.), por as u është kthyer si truall dhe as nuk kanë marrë kompensim për të”.*

23.6 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë e në përputhje me ligjin dhe se ndodhet në kushtet e gërmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

24. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

24.1 Analiza financiare është kryer për periudhën 2003 – 2016, nga e cila subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 26,927,779 (njëzetë e gjashtë milionë e nëntëqind e njëzetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë (kumulative), për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e tij në raport me të ardhurat e ligjshme të konsideruara nga Komisioni deri në këtë fazë të hetimit.

24.2 Në këtë analizë nuk janë përfshirë pasurit e tjera të personave të tjerë të lidhur (prindërit e subjektit), për të cilat Komisioni ka dyshime se janë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, duke kryer për to analiza financiare të veçanta për prindërit, deri në këtë fazë të hetimit.

24.3 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit dhe burimet financiare të ligjshme sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

24.4 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimi ka sjellë shpjegime lidhur me analizën financiare dhe Komisioni i ka marrë në konsideratë si vijon:

- a) Shpenzimet e jetesës për vitet 2013 – 2016, duke i marrë në konsideratë për një person sipas pretendimeve të subjekti të rivlerësimit, duke i vlerësuar ato të drejta.
- b) Shpenzimet *TIMS* janë llogaritur vetëm për subjektin e rivlerësimit duke mos i ngarkuar shpenzime për udhëtimet e shtetasës V. P., sipas kërkesës së subjektit.
- c) Komisioni ka llogaritur si shpenzim për ish-bashkëshorten në vitin 2012 (kur janë divorcuar) vlerën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.
- ç) Komisioni ka llogaritur si të ardhur vlerën 1,000,000 (një milion) lekë në vitin 2003, të sjellë nga ish-bashkëshortja si pasuri të saj kur është martuar me subjektin. Kjo e ardhur lidhet me depozitën e ish-bashkëshortes në “Bankën Italo-Shqiptare”.

24.5 Në përfundim, subjekti rivlerësimit rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 22,375,501 (njëzetë e dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e një) lekë për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e tij në raport me të ardhurat e ligjshme të konsideruara nga Komisioni.

25. Në përfundim të vlerësimit për kriterin e pasurisë, pas vlerësimit të rezultateve të hetimit në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të barrës së provës, si dhe vlerësimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë hetimit dhe akteve të administruara në vijim të barrës së provës dhe dëgjimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues i Komisionit arriti në konkluzionin se provat për kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit të Komisionit për një pjesë të madhe të tyre.

26. Trupi gjykues i vlerëson këto konkluzione si të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

27. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi të panevojshëm hapjen e hetimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me këtë kriter të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

28. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruar, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në pikat 1, 3 dhe 5 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Kreshnik Omari, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 6.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku

